

1 E enjte, 18 shtator 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, paraqisni lëndën ju lutem.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej për
12 procesverbal që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit.

14 Sot do të vazhdojmë me dëgjimin e dëshmisë së Dëshmitarit
15 të Mbrojtjes së z. Thaçi 1DW-001.

16 Përpara sesa të fillojmë me dëshmitarin, kemi disa
17 çështje paraprake që dëshirojmë të trajtojmë. Sa i takon javës
18 që vjen, a mund të na thotë Mbrojtja e Thaçit në qoftë se ka
19 ndonjë ndryshim lidhur me rendin e dëshmitarëve të planifikuar
20 paraprakisht?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.
22 Nuk ka ndryshime. Dhe, përpara orës 4.00 pasdite, do ju
23 dërgojmë njoftimin lidhur me dëshmitarin për javën që vjen.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
25 ndryshim sa i takon kohës që vlerësoni që do t'i bëni pyetje

1 dëshmitarit për palët e tjera?

2 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jo, nuk kemi
3 asnjë ndryshim në këtë fazë.

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] As ne nuk kemi ndryshim.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kemi as ne asnjë ndryshim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ZPS-ja ka
7 ndonjë ndryshim sa i takon kohës së vlerësuar që do të përdorë
8 me dëshmitarin javën që vjen?

9 Z. PACE: [Përkthim] As ne nuk kemi ndryshim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa i takon
11 bllokut pasardhës të dëshmitarëve, a mund të na ofrojë
12 informacion Mbrojtja lidhur me informacionin që ka të bëjë me
13 ofruesit e informacionit sipas rregullës 107?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Komunikimi i fundit është që Trupi
15 Gjykues do njoftohet përmes Zyrës Administrative. Deri tani
16 nuk kemi marrë një përgjigje, kështu i që nuk kemi çfarë themi
17 tjetër për momentin.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Znj. Sekretare, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të korrigjoj atë çfarë thashë.
21 Informacioni që është dërguar ofruesit të informacionit, në
22 fakt, kërkesa i është dërguar të martën, jo dje, i kemi
23 dërguar një kërkesë urgjente dhe presim të na kthejnë
24 përgjigje. Do ju njoftojmë përmes Zyrës Administrative.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
2 Dr. Williams.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
5 vazhdojmë me dëshminë tuaj sot. Ju rikujtoj që duhet t'i jepni
6 përgjigje pyetjeve me fjali të shkurtra dhe të qarta. Në qoftë
7 se një pyetje nuk e kuptoni, lirisht mund t'i tregoni avokatit
8 përkatës që nuk e kuptoni ose kërkoni që të jepen specifikime
9 ose hollësi të tjera për pyetjen.

10 Ju kujtojmë që të thoni se cila është baza e njohurive
11 lidhur me faktet dhe rrethanat për pyetjet që do t'ju bëhen.

12 Ju rikujtoj që jeni nën detyrimin që të thoni të vërtetën
13 ashtu siç keni deklaruar në betim solemn dje.

14 Duhet të flisni pranë mikrofonit, duhet të bëni një pauzë
15 prej pesë sekondash përpara sesa të jepni përgjigje për
16 pyetjet dhe duhet të flisni ngadalë në mënyrë të tillë që t'ju
17 kapin përkthyesit plotësisht.

18 Së fundi, në qoftë se e keni të nevojshme që të bëni
19 ndonjë pushim, mund të na e thoni këtë gjë dhe ne do të bëjmë
20 organizimet përkatëse.

21 Do të fillojmë tani me pyetje nga anëtarët e Trupit
22 Gjykses.

23 Gjykatësi Barthe është i pari i cili do t'ju bëjë pyetje.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Kryegjykatës.

25 DËSHMITARI: PAUL WILLIAMS [Vijon]

Dëshmitari: Paul Williams (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 4

1 Pyetje nga Trupi Gjykses:

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëmëngjes, Dr. Williams.

3 PË. Mirëmëngjes.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Trupi Gjykses ka disa pyetje
5 të tjera për ju për të sqaruar disa çështje të cilat nuk i
6 kemi plotësisht të qarta. Për këtë arsye dua që të shohim
7 deklaratën që i keni dhënë Mbrojtjes në vitin 2021, në prill
8 2022 dhe në korrik 2025 dhe që kemi pranuar në prova materiale
9 si 1D375, të shohim në qoftë se mund të na ndihmosh lidhur me
10 këtë.

11 Dëshiroj që të filloj me një seksion që e ka titullin
12 "Përfshirja me Kosovën", aty ju përshkruani sesi u bëtë
13 këshilltar i *pro bono* ose falas i delegacionit kosovar në
14 Rambuje në bisedat e pages dhe në Paris më pas në shkurt dhe
15 në mars të vitit 1999.

16 Në paragrafin 17 të deklaratës tuaj ju thoni që në
17 Rambuje jeni takuar me anëtarë të diasporës, me një anëtar të
18 diasporës kosovare që lidhej me UÇK-në, dikë që ju e njihnit
19 mirë dhe ky individ e identifikonte veten si anëtar të UÇK-së.
20 Pasi ju u takuat me të, ai shkroi në një letër disa shënime, e
21 palosi disa herë dhe ua dha juve për t'ua dhënë Hashim Thaçit
22 kur të ktheheshit në kështjellë. Kolegu nga diaspora ju tha që
23 duhet ta informonit z. Thaçi dhe ai ju besonte juve sepse ju
24 ishit këshilltar i delegacionit.

25 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar? E shikoj që

1 tundni kokën në shenj pohuese.

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju lutem na thoni cilët
4 ishin këta persona? Thoni që ishte një person që e njihnit
5 mirë, ky personi nga diaspora kosovare që ju e njihnit mirë
6 ishte Dino Hasani?

7 PË. Po.

8 PY. Ju bëri gjithashtu Prokuroria të njëjtën pyetje në
9 intervistën më datën 2 shtator 2025, a e dini kush ka qenë
10 personi që e ka shkruar shënimin tek fleta që ju dha juve?

11 PË. Mua më kujtohet nga pamja personi, domethënë, mund ta
12 dalloj nga pamja, po nuk e di sesi quhej, nuk më kujtohet emri
13 i tij. Në atë kohë, besoja që ai të ishte i lidhur me një
14 komandë lokale, në qoftë se nuk ishte komandant vetë. Mund të
15 shtoj një ose dy fjali të tjera po nuk e di sesi quhet
16 personi.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull.

18 Dr. Williams, në faqen 84 të transkriptit të ditës së
19 djeshme, transkriptit në kohë reale, ju e quajtit Dino Hasanin
20 këshilltar. A e dini në qoftë se Dino Hasani ka qenë anëtar i
21 vërtetë i UÇK-së apo thjesht lidhej, e quante veten si të
22 lidhur me UÇK-në?

23 PË. Po. Për shkak të faktit që Dino Hasani ishte amerikan, ai
24 ishte shumë i kujdesshëm që të mos bëhej delegacion *de facto*
25 anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për shkak të ligjit

1 amerikan që i ndalon shtetasit amerikanë që të bashkohen në
2 lëvizje të armatosura jo shtetërore jashtë shteti. Kështu që
3 jam i sigurtë që ai do ketë respektuar këtë detyrim si shtetas
4 amerikan dhe vetëm thjesht i ka dhënë këshillim UÇK-së dhe e
5 ka udhëzuar UÇK-në.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në faqen 90 të
7 transkriptit të ditës së djeshme, ju thoni që z. Hasani më pas
8 u bë përfaqësues i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës në
9 Shtetet e Bashkuara, a është e saktë kjo, Dëshmitar?
10 PË. Po.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na thoni ose a ju
12 kujtohet se kur është emëruar ai në këtë pozicion në këtë
13 post?

14 PË. Shumë herët në proces. Me aq sa më kujtohet mua, duhet të
15 ketë qenë diku nga vera e vitit 1999, pas përfundimit të
16 bombardimeve ajrore të NATO-s.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet se kush e ka
18 emëruar atë?

19 PË. Mund të ketë Qeveria e Përkohshme.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kush në Qeverinë e
21 Përkohshme nëse e dini?

22 PË. Nuk e di. Në qoftë se doni mund të jap ca informacion
23 tjetër plotësues në kontekst, por jo të hollësishëm.

24 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull, vazhdoni.

25 PË. Qeveria e Përkohshme ishte e gatshme që të kishte

1 përfaqësim politik në Washington DC në mënyrë që shtetet e
2 panjohura ose qeveritë e panjohura të kishin njohje politike.
3 Dhe për këtë arsye ata i kanë kërkuar Dinos, me sa di unë,
4 përderisa ai ishte shqiptaro-amerikan në Amerikë dhe nuk
5 kishte nevojë për viza dhe kishte ca lehtësira të tjera në
6 qoftë se ai do të shërbente ose ishte i gatshëm që të
7 shërbente si përfaqësues në Washington dhe për komunitetin
8 shqiptar atje.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur ai është emëruar në
10 verën të 1999-s, sikurse e thatë juve, pas fushatave ajrore, a
11 ishte problem për z. Hasani apo që ai të bëhej përfaqësues i
12 një organizate që ishte etiketuar të paktën, siç e dëgjuam
13 dje, nga administrata e Kombeve të Bashkuar në fillim të vitit
14 1999, si organizatë terroriste?

15 PË. Unë nuk i kam dhënë Dinos këshillim juridik për të
16 drejtën amerikane. Kjo shkon përtej fushëveprimit të asaj
17 çfarë bëj unë. Përtej fushës sime të ekspertizës. Megjithatë
18 unë mund të them me siguri që Dino ka kërkuar këshillim
19 juridik sa i takon ligjit ose aktit për regjistrimin në punët
20 e jashtme. Kështu që personi në fjalë, pra, Dino, ishte
21 biznesmen, ishte një person i cili i dinte kompleksitetet e i
22 dinte ligjet, dhe jam i sigurtë që ai do jetë interesuar dhe
23 do ketë qenë i sigurtë që nuk do të shkaktoheshin probleme për
24 të.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A jeni në dijeni që z.

1 Hasani mund të ketë pasur probleme si përfaqësues i Qeverisë
2 së Përkohshme të Kosovës në SHBA?
3 PË. Po. Tensionet mund të kenë qenë të lidhura me faktin që
4 NATO sapo kishte filluar fushatën ajrore e bombardimet. Ato po
5 kërkonin që të gjenin një bazë për administrimin ndërkombëtar
6 të Kosovës përmes Rezolutës së Sigurimit të Kombeve të
7 Bashkuara 1244 dhe mekanizmave të tjerë. Dhe kosovarët duke
8 qenë që ishin shumë aktivë, pra, kishin caktuar tanimë një
9 përfaqësues në Washington DC. Kështu që pjesë e reagimit
10 politik prej qeverisë amerikane ishte: Prisni një çast, është
11 ende herët, ne ende nuk i kemi sqaruar gjërat.

12 Për shembull, malazezët kishin një përfaqësues tregtar,
13 Zorica, e kishte emrin dhe ai bënte aktivitete të tjera. Por
14 nga ana tjetër Dino po mendohej që të kopjonte atë çfarë bënin
15 personat e tjerë. Por kishte një lloj presioni ose një lloj
16 trysnie që duhet që të sqarojmë disa gjëra të tjera njëherë më
17 tepër sesa të kemi dikën i cili flet dhe i cili hiqej si
18 përfaqësues politik.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju thatë përfaqësim politik.
20 A mund t'ju them konkretisht se çfarë ka bërë z. Hasani si
21 përfaqësues i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, çfarë roli
22 ka pasur, çfarë detyrash ka kryer?

23 PË. Sigurisht. Unë dhe Dino kemi bërë biseda të shumta lidhur
24 me gjërat që ai mund të bënte si përfaqësues. Ai kryesisht ka
25 qenë i kufizuar tek komuniteti i organizatave të ndryshme,

1 *think tank* dhe për të siguruar, për shembull, që Kosova të
2 ishte pjesë e bisedave të ndryshme. Për shembull, kur kishte
3 grupe pune apo kur kishte mbledhje të tilla të kësaj natyre.
4 Unë nuk besoj se ka pasur shumë qasje në Capitol Hill sepse ai
5 ende, pra, kishte detyrimet që të respektonte ligjet
6 amerikane. Jam 65 për qind besimplotë për këto fakte,
7 megjithatë jam i sigurtë që kongresmenët apo senatorët do
8 ishin, jam i bindur, duhet të ishin më pro kalimit të kohës me
9 Këshillin Shqiptar Amerikan, domethënë, në qoftë se kishte
10 çështje për t'i trajtuar me ta më tepër sesa t'i trajtonin me
11 z. Hasani si përfaqësues i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A jeni në dijeni në qoftë se
13 z. Hasani ka shkruar letra administratës amerikane ose, për
14 shembull, senatorëve apo kongresmenëve të caktuar politikanëve
15 dhe njerëzve me rëndësi në Amerikë?

16 PË. Nuk e di me siguri. Nuk është se kam parë letra që mund
17 të ketë shkruar ai, të cilat do kishin qenë përtej kontekstit
18 tim, se, për shembull, unë si amerikan unë nuk jap këshillim
19 për sa i takon politikave të Shtetet e Bashkuara se nuk është
20 kjo natyra e punës time. Pra, në qoftë se Dino do me këtë
21 kërkuar mua që hidhi një sy kësaj letre përpara sesa t'ia
22 dërgojë një senatori të caktuar jam i sigurtë që di kisha
23 thënë jo, nuk është puna ime kjo, nuk dua të përfshihem në
24 këtë çështje.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet që të ketë

1 ndodhur kjo gjë, ju kujtohet që të ketë pasur ndonjë rast kur
2 Dino ka ardhur, ju ka treguar një letër dhe ju ka thënë
3 shikoheni për mua?

4 PË. Nuk më kujtohet. Nuk ka besoj se ka ndodhur një rast i
5 tillë.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani le të kalojmë në një
7 temë tjetër, që është në paragrafin 31 të deklaratës tuaj. I
8 keni thënë Mbrojtjes si më poshtë dhe këtu citoj:

9 "Në fillim të raundit të negociatave të Rambujesë
10 delegacioni i Kosovës zgjodhi presidencën ose kryesinë e
11 delegacionit i cili përbëhej prej Ibrahim Rugovës, Hashim
12 Thaçit dhe Rexhep Qosjes. Dhe ata ranë dakord që kryetari të
13 zgjidhej me shumicë vote. Për rrjedhojë u zgjodhe Hashim
14 Thaçi. Me kalimin e kohës Veton Surroi mori një rol joformal
15 si anëtar i katërt i kryesisë edhe, në fakt, ishte një prej
16 katër nënshkruesëve të marrëveshjes."

17 A e dini, Dr. Williams, se sa anëtarë ka patur
18 delegacioni i Kosovës në Rambuje edhe në Paris?

19 PË. 16.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini se cilët ishin
21 anëtarët e tjerë, domethënë, a mund të thoni me emër se cilët
22 kanë qenë disa prej anëtarëve të tjerë përveç emrave që
23 përmenda pak më herët, katër personave që përmenda më herët,
24 z. Rugova, Thaçi, Qosja dhe Surroi?

25 PË. Bujar Bukoshi, Edita Tahiri, Jakup Krasniqi, Blerim

1 Shala, Dugi, për të cilin unë bisedova dhe dje dhe që ka qenë
2 i pranishëm aty. Po mundohem që të gjej emrat e anëtarëve të
3 LDK-së, domethënë, po mundohem që të kem parasysh përbërjen e
4 delegacionit siç kanë qenë të ulur në tavolinë. A ka pasur
5 gjithashtu edhe disa vende për t'u ulur për këshilltarë
6 shqiptarë të Kosovës, Bajram Kosumi, po ashtu ka qenë anëtar i
7 delegacionit dhe unë, Mort Abramovitz, që ishte ish-ambasador,
8 unë vetë dhe këshilltarët e tjerë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju bë pyetja disa herë dje
10 në qoftë se ju kujtohet që z. Veseli të ketë qenë anëtar i
11 delegacionit apo të ketë qenë i pranishëm në Rambuje apo në
12 Paris dhe ju u përgjigjët që nuk ju kujtohet. A është kështu
13 edhe sot, Dëshmitar?

14 PË. Po, kështu është edhe sot. Do shtoj dhe Ramën. Edhe Rama
15 ka qenë një prej anëtarëve të delegacionit. Ju kërkoj ndjesë
16 që nuk e thashë më përpara po tani mu kujtua.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pa problem. Dr. Williams, a
18 e dini se pse është zgjedhur z. Thaçi si kryetar? Juve e keni
19 thënë më përpara se nuk keni qenë i pranishëm në procedurën e
20 zgjedhjes apo të përzgjedhjes. Z. Thaçi në atë kohë, pra, në
21 shkurt të 1999 a ka qenë një personalitet i spikatur në
22 Kosovë?

23 PË. Pyetja jua përbëhet prej dy pjesëve të ndryshme ose ka
24 dy pyetje në një pyetje. Me aq sa di unë dhe, në fakt, për të
25 sugjeruar propio Gjykatësi që unë të them atë çfarë di, pra,

1 mbi bazën e njohurive të shprehur. Me aq sa di unë, tre prej
2 tyre ishin përzgjedhur me konsensus dhe kjo vjen nga
3 procesverbali i takimit të 7 shkurtit që më ka treguar Edita
4 Tahiri. Domethënë, gjithashtu më është dhënë dokumenti që më
5 lejonte mua që të futesha në kështjellë, domethënë,
6 procesverbali takimit ishte dokumenti që më bënte mua të
7 mundur që të futesha.

8 Rugova ishte LDK-ja. Ishte Qosja nga LBD-ja dhe Thaçi nga
9 UÇK-ja. Vendimi u morr 2 me 1, pra, Qosja votoi për Thaçin.
10 Thaçi votoi për veten dhe kjo ishte mënyra sesi u zgjodh z.
11 Thaçi. Dhe kështu ishin, domethënë, këto ishin votat 2 pro
12 Thaçit dhe 1 kundër tij.

13 Pjesa e dytë e pyetjes tuaj dhe mënyra sesi e kuptova unë
14 pyetjen tuaj është kjo dhe, më thoni në qoftë se e kuptova siç
15 duhet apo jo, pse u zgjodh Hashim Thaçi si fytyra e
16 negociatorit për UÇK-në. Ju lutem më thoni a e kuptova drejt
17 apo jo?

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po kjo ishte pyetja.
19 PË. Ju lutem më thoni në qoftë se po flas më shumë se
20 ç'duhet, po jap më shumë informacion kontekstual se ç'duhet.
21 Por ideja ishte që ekzistonte dëshira për procesin e
22 pavarësisë së Kosovës dhe kjo çështje ishte me shumë shtresa.
23 Rugova ishte pacifisti. Dhe Rugova ishte pro pavarësisë.
24 Domethënë, ai nuk e hapte gojën në qoftë se nuk bihej dakord
25 për pavarësinë. Kishim punën e Bukshit që ishte më shumë i

1 nuancuar, punonte me amerikanët, me evropianët. Ndërkohë që
2 kishim edhe veprimin e aktorëve jo shtetëror, lëvizjet
3 vetëvendosja që ishin të rëndësishme dhe pastaj nga ana tjetër
4 kishim një dimension tjetër të vetëvendosjes, strategjisë për
5 pavarësinë. Kështu që në negociata ti doje që të kishe një UÇK
6 që të tregonte përmes veprimeve dhe fjalëve dhe angazhimeve të
7 veta që ky person i UÇK-së të ishte një negociator, një
8 diplomat që mund të ishte një persona ose një partner i
9 besueshëm. Edhe një herë ju thashë në qoftë se po flas më
10 shumë seç duhet ma thoni.

11 Por kur i kam këshilluar klientët dhe negociatorët e
12 pages, unë ju kam thënë atyre që delegacioni juaj duhet të
13 ketë personazhe të ndryshme, karaktere të ndryshme, persona me
14 vlera të ndryshme në mënyrë të tillë që negociatori të jetë
15 figura kryesore, negociatori duhet që të sillet në një mënyrë
16 të caktuar po nga ana tjetër duhet të keni dhe dikënd që ka më
17 shumë aftësi komprometuese, dikush që nuk lëshon pe dhe
18 sigurisht që keni nevojë edhe për një këshilltar. Pra,
19 sigurisht që kur ndërton një ekip duhet që të marrësh parasysh
20 karakteristikat e personave, çfarë vlere apo çfarë
21 karakteristikash shfaqin ata.

22 Edhe një herë në qoftë se po flas më shumë se ç'duhet më
23 thoni që të ndaloj. Tani që mendoj në retrospektivë, dy të
24 tretat e negociatorëve me të cilët unë kam punuar, personi i
25 cili kapur autoritet komande edhe kontrolli zakonisht nuk

1 është në sallë, nuk është në dhomë. Për shembull, kohët e
2 fundit, unë kam këshilluar një koalicion opozitar sirian në
3 negociata në Gjenevë dhe i kam këshilluar ata që personi që
4 kishte kontroll të qëndronte jashtë negociatave apo të ishte
5 në Gjenevë dhe të qëndronte në një hotel tjetër nga aty ku
6 qëndronte pjesa tjetër e delegacionit.

7 Kjo është për t'ju shpjeguar juve se si funksionon ajo
8 çfarë bëj unë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Arsyeja që pse po jua bëj
10 këto pyetje është që ajo çfarë mund të shihet si befasia ishte
11 fakti që z. Rugova nuk u përzgjedhe si kryetari, ndërkohë që
12 z. Rugova ishte një figurë shumë e spikatur dhe ishte ende
13 presidenti i zgjedhur i Kosovës, apo jo, për këtë arsye jua
14 bëra pyetjen, Dëshmitar?

15 PË. Po, është e saktë ai ishte ende presidenti i zgjedhur i
16 Kosovës. Dhe përgjigja për pyetjen tuaj në qoftë se ishte apo
17 jo befasia. Unë mund t'ju them që jo nuk ishte befasia. Mund
18 t'ju shpjegoj?

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, vazhdoni ju lutem.

20 PË. Presidenti Rugova, që ishte personi i parë që unë kam
21 ofruar shërbimet e mia, pra, që kam këshilluar përmes Bujar
22 Bukoshit, e respektonte shumë, e admironte shumë çdo bisedë që
23 një ndërkombëtar bënte me Ibrahim Rugovën. Dhe gjithmonë ai
24 përfundonte me dy fjali dhe këto fjali ishin: Pavarësia dhe
25 mospërdorimi i forcës. Dhe pastaj le të diskutojmë, e tjerë e

1 tjerë. Dhe gjatë gjithë kohës këto i kishte dy kryefjalët
2 kryesore pavarësinë dhe mospërdorimin e forcës.

3 Presidenti Rugova ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm
4 në Rambuje për përfaqësimin e popullit të Kosovës. Komuniteti
5 ndërkombëtar do kishte qenë shumë i shqetësuar në qoftë se
6 komuniteti ndërkombëtar do i duhej të negocionte me të si
7 negociatorin kryesor. Sa i takon rolit të tij, roli i tij
8 ishte shumë i rëndësishëm. Idetë e tij pacifiste, gjithashtu
9 edhe aspiratat e tij për pavarësi, por nuk ishte negociator,
10 nuk negocionte. Në qoftë se ju vjen në ndihmë, në qoftë se i
11 dhashë përgjigje pyetjes tuaj.

12 Ky është njëri dimension. Në qoftë se doni mund të them
13 edhe të tjera gjëra. Një aspekt tjetër është që kishte
14 ndryshim situata, ndryshim të ngjyrave të kaleidoskopit, në
15 qoftë se do thosha figuratisht, kishte realitete politike të
16 tjera në terren. Dhe shqiptarët do kishin thënë që "Bujari
17 është kryeministri, kemi Ibrahim Rugovën, por ata tani nuk do
18 negociojnë", por nga ana tjetër ndërkombëtarët do kishin thënë
19 "Po aktorët jo shtetërorë të armatosur ku janë? Sepse pa
20 diskutim që ata kishin rol shumë të rëndësishëm. Pa diskutim
21 që ata kërkonin pavarësinë". Por nga pikëpamja ime të duhej ky
22 lloj konstelacioni, të duhej kjo lloj përbërje me të gjithë
23 aktorët të përfshirë që të gjendej një zgjidhje. Në atë kohë
24 UÇK-ja shikohej si një dimension shumë i rëndësishëm i
25 përbërjes politike të Kosovës, pra, kishte një rol shumë të

1 rëndësishëm.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Dr. Williams.

3 Pyetja ime e radhës ka të bëjë me paragrafin 32 të
4 deklaratës tuaj, në këtë paragraf ju përshkruani që z. Thaçi u
5 largua nga kështjella shkoi për në Slloveni për një ditë për
6 t'u takuar me Adem Demaçin. Këtu ju thoni që ju e kuptuat që
7 ky ishte një takim i rëndësishëm për të siguruar mbështetjen e
8 z. Demaçi për nënshkrimin e marrëveshjes.

9 A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë Mbrojtjes, Dëshmitar?
10 PË. Po.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dr. Williams, a mund të na
12 thoni kur ka ndodhur kjo? Më 19 shkurt 1999, kjo ka qenë data
13 kur z. Thaçi u largua prej kështjellës për të udhëtuar drejt
14 Sllovenisë?

15 PË. Nuk më kujtohet data konkrete, por ishte gjatë pjesës së
16 fundit të negociatës dhe kështu që nuk e di, domethënë, mendoj
17 që ka qenë ose një ditë përpara ose një ditë më pas nga dita
18 kur Chris Hill shkoi për t'u takuar me Milosevic. Se e mbaj
19 mend që pyesja veten, e kam bërë këtë pyetje pse u largua nga
20 kështjella z. Thaçi.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na e shpjegoni se
22 çfarë doni të thonit kur thatë që takimi me z. Demaçi ishte
23 kritik ose mbështetja e z. Demaçi ishte kritike por ishte
24 shumë e rëndësishme për nënshkrimin e marrëveshjes së pages,
25 na e shpjegoni pak më tej ju lutem, Dëshmitar.

1 PË. Po një pauzë jo vetëm për përkthyesit, megjithatë ajo
2 çfarë mund t'ju them është që t'ju jap pikëpamjen që unë kam
3 pasur asokohe, domethënë, çfarë këndvështrimi ose çfarë kam
4 menduar kur kam qenë në Rambuje, domethënë, do ju tregoj një
5 herë se çfarë kam menduar atëherë në Rambuje. Pastaj në qoftë
6 se doni që të dini në qoftë se mendimi im ka ndryshuar me
7 kalimin e kohës mund të ma bëni këtë pyetje më pas.

8 Gjithsesi duke iu rikthyer Rambujesë, situatës atje,
9 dinamika në Rambuje ishte që delegacioni i Kosovës, përfshirë
10 këtu dhe Hashim Thaçin, ishte nën presion nga dy aspekte. Nga
11 shumë aspekte në fakt, dua të korrigjoj veten se nuk dua të
12 përfshij shoqërinë civile, personat e zhvendosur brenda për
13 brenda vendit, OJQ, e tjerë e tjerë. Megjithatë, për arsye të
14 kësaj bisede që po kemi kishte një presion të jashtëzakonshëm
15 nga komandantët lokalë dhe kishte gjithashtu edhe presion
16 ideologjik dhe kulturor veçanërisht nga Adem Demaçi.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dua atëherë t'ju ndaloj këtu
18 se do kalojmë tek kjo pyetje më vonë por dua që t'i
19 përgjigjeni pyetjes që ju bëra përpara një çasti. Ju thatë pak
20 më herët që Adem Demaçi ishte shumë i rëndësishëm, domethënë,
21 mbështetja e tij ishte kritike për nënshkrimin e marrëveshjes
22 apo po thoni që takimi ishte shumë i rëndësishëm ishte kritik.
23 Mund të na e sqaroni?

24 PË. Takimi ishte shumë i rëndësishëm apo ishte kritik sepse
25 Hashim Thaçi duhej të tregonte, duhej të demonstronte që ai po

1 përfshihej me Adem Demaçin në kuptimin që ai kishte komunikim
2 me Adem Demaçin se Adem Demaçi po thoshte shumë gjëra nga
3 jashtë. Adem Demaçi ishte një person intelektual, një person
4 shumë i respektuar, një person në moshë shumë më të thyer,
5 kështu që në mënyrë të tillë që të nënshkruante marrëveshjen
6 ishte e rëndësishme e domosdoshme do thoja për të, pra, për
7 Thaçin, që të kishte një bisedë, të shkonte të takonte Adem
8 Demaçin dhe të bënte një bisedë me të. Po mundohem të shprehem
9 shumë me kujdes, të zgjedhë fjalët.

10 Mua nuk më është krijuar përshtypja konkretisht që atij
11 i duhej që të merrte miratim ose që të kishte një lloj
12 konsultimi të mirë, domethënë, po mundohem që të jem më
13 specifik e tjerë e tjerë, po mundohem të jem i zgjedhur në
14 fjalët që po përdor sepse thashë që është e nevojshme
15 mbështetja dhe për këtë arsye u largua Hashim Thaçi nga
16 kështjella. Pra, nuk e di në qoftë se ju ndihmoi shpjegimi im
17 apo jo, por edhe një herë do doja të thoja që ishte e
18 rëndësishme që Adem Demaçi të mund t'i jepte mbështetjen e tij
19 për nënshkrimin e marrëveshjes.

20 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Atëherë vazhdojmë më tej në
21 dëshminë tuaj. Në faqen 86 të transkriptit të djeshëm, ju
22 thoni që kolegët shqiptaro-amerikanë në kështjellë, pra, donin
23 që Hashim Thaçi të takohej me Adem Demaçin dhe kjo ishte e
24 nevojshme për arsye politike dhe kulturore. Këto ju i
25 përshkruani si arsye politike dhe kulturore?

1 PË. Po.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dje thatë Dr. Williams se
3 nuk e keni takuar asnjëherë z. Demaçi?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e dini nëse z. Demaçi
6 kishte ndonjë pozitë, ndonjë rol apo nëse ishte pjesëtar i
7 UÇK-së, kishte pozitë apo rol në UÇK kur ishte anëtar apo nëse
8 ishte anëtar i UÇK-së?

9 PË. Pas kohës që kaloi në Rambuje bëra kërkime në Google. Dhe
10 sipas internetit ishte zëdhënës për UÇK-në. Por kjo nuk është
11 diçka që e dija në kohën që isha në Rambuje.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. E dimë se z.
13 Thaçi nuk ka arritur të sigurojë mbështetjen e z. Demaçi për
14 marrëveshjen e paqes. Që të sigurohem që ju kam kuptuar drejt,
15 a ishte problemi se z. Demaçi këmbënguli që të kishte pavarësi
16 të menjëhershme dhe të plotë, a ishte problemi se z. Demaçi
17 këmbënguli që të kishte pavarësi të menjëhershme dhe të plotë,
18 a ishte ky problemi pra?

19 PË. Dy pjesë për t'ju përgjigjur kësaj pyetjeje. E dyta,
20 është, po, Adem Demaçi, ashtu siç ishte Rugova që kishte një
21 pikë në të cilën fokusohet që ishte pavarësia e vendit, pra,
22 përfaqësonte pavarësinë dhe lëvizjen paqësore, Adem Demaçi
23 kishte dy pika kryesore, që i përsërite vazhdimisht, ishte
24 pavarësia dhe ne jemi gati të luftojmë. Ai nuk ndryshoi nga
25 kjo, nuk lëvizi nga sa e kam kuptuar unë.

1 Është me vend të shtohet gjithashtu që pjesa e arsyes për
2 të vizituar Adem Demaçin, për t'i bërë një vizitë atij, ishte
3 që të takohet me të dhe në mënyrë ideale ishte që të merrej
4 mbështetja e tij në qoftë se ai do të ndryshonte retorikën e
5 tij. Por në qoftë se personi është nën presion nga komandantët
6 vendorë dhe ke ndikim ideologjik nga Adem Demaçi, pëson
7 ndikimin ideologjik të tij, një prej mënyrave për të zvogëluar
8 këtë trysni këtë presion është që të shkosh e të bësh një
9 bisedë ose të paktën të përpigesh, ta provosh, të bësh një
10 konsultim, një bisedë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dr. Williams, gjatë
12 bisedimeve të brendshme në *chateau* një prej anëtarëve të
13 delegacionin shqiptar të Kosovës, pra, në mes të këtyre
14 pjesëtarëve, a mund të na thoni cili ishte qëndrimi i z. Thaçi
15 lidhur me pavarësinë? Ai ishte për në favor të pavarësisë apo
16 ishte kundër pavarësisë apo si kundër pavarësisë si kusht i
17 domosdoshëm për nënshkrimin e marrëveshjes?

18 PË. Po. Hashim Thaçi dhe do të thoja të gjithë anëtarët e
19 delegacionit shqiptar të Kosovës dhe ekspertët e tyre kosovarë
20 shqiptarë kërkonin pavarësinë, pra, pavarësia ishte e
21 domosdoshme. Kam kaluar shumë kohë duke ju shpjeguar atyre
22 mënyrën, rrugën sesi mund të arrinin pavarësinë në qoftë se
23 fjala pavarësi nuk përmbahej nuk gjendej në marrëveshjen e
24 Rambujesë. Në qoftë se fjala vetë pavarësi, pra, kjo më ka
25 kërkuar shumë energji, shumë biseda, shumë mendime,

1 reflektime. Por ju kam thënë që në qoftë se vini dhe thoni
2 "Unë jam kështu, kështu nga Kosova", "Pavarësia" është fjalja
3 e radhës që dilte nga goja e tyre. Hashim Thaçi ishte në këtë
4 situatë, pra, ku si gjithë të tjerët.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dr. Williams, kam një pyetje
6 të shkurtër lidhur me paragrafin 35 të deklaratës suaj ku ju
7 keni thënë se kur jeni takuar për herë të parë me z. Thaçi në
8 Rambuqe dukej, përshtypja juaj ishte që ai ishte përzgjedhur
9 të ishte pjesë përbërëse e UÇK-së, pra, si përfaqësues i UÇK-
10 së për delegacionin e Kosovës sepse kishte kaluar kohë në
11 Zvicrës dhe ju thanë që kishte një lloj niveli familjariteti
12 njohurie me komunitetin ndërkombëtar.

13 A mund ta shpjegoni çfarë kishit në mendje kur thatë që
14 kishte njohuri, një lloj familjariteti me bashkësinë
15 ndërkombëtare?

16 PË. Po mendohem tani. Në atë kohë kjo ka qenë pjesë e një
17 paragrafi, një shpjegimi që kam dhënë në një paragraf kur
18 pyeta shqiptarin e Kosovës apo dikë tjetër dhe u kam thënë "Ou
19 Hashim Thaçi". "Është i ri. Ka studiuar në Zvicër. Përmbush
20 ato kriteret që na duhen neve për fytyrën e personit që do të
21 përfaqësojë negociatat, bisedimet". Dhe si deklaratë faktike,
22 kjo është ajo që kam dëgjuar dhe kjo është ajo që gjendet
23 rrjedhimisht në deklaratën time.

24 Dhe shkalla e familjaritetit, pra, njohurive që kishte
25 afërsisë me bashkësinë ndërkombëtare. Dhe dua të jem i

1 kujdesshëm këtu kur ta përshkruaj këtë pjesë, ai ishte larguar
2 nga Kosova. Dhe po përpigem të zgjedh fjalët me kujdes kur
3 përshkruaj, pra, nuk ishte fshatar, pra, kjo ishte mënyra,
4 pra, një mënyrë për të thënë që nuk ishte fshatar, nuk ishte
5 nga zonat e thella rurale apo malore, kishte studiuar në
6 Zvicër, dinte se si të sillej dhe në prani apo në bashkësinë
7 ndërkombëtare sepse kishte gjendje stresi, ankth, siç është
8 gjithmonë në rastet kur bëhet fjalë për aktorë të armatosur jo
9 shtetërorë, që ata krijojnë një lloj personaliteti, një lloj
10 karakteri që sipas të cilit duhet të sillen në një kontekst
11 negociatash që të mos ndërpresë, pra, të mos shkaktojë dëmin e
12 negociatave.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull.

14 PË. Po përpigem të jem i sjellshëm në përshkrimin tim.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju përgjigje pyetjes time.

16 Faleminderit.

17 Një pyetje tjetër është në paragrafin 37 të deklaratës
18 tuaj, ku ju keni thënë se mungesa e autoritetit të z. Thaçi
19 ishte e dukshme e qartë kur erdhi koha për t'u angazhuar në
20 mënyrë formale për marrëveshjen që po negociohej nga
21 Sekretarja Albright. Dhe ju thatë se përkthyesi për një arsye
22 apo tjetër nuk e përktheu fjalën kur z. Thaçi shpjegoi se ai
23 nuk mund të nënshkruante marrëveshjen, se z. Thaçi nuk ishte i
24 autorizuar të pajtohej me propozimin. Në vend të kësaj,
25 përkthyesi e përqendroi përkthimin e tij, siç thatë ju, sipas

1 deklarates tuaj, në pjesën hyrëse të deklaratës së Thaçit ku
2 Thaçi shprehu mirënjohjen e tij për Amerikën dhe entuziazmin
3 për procesin e pages. Dhe pastaj z. Surroi foli dhe tregoi se
4 përkthyesi nuk kishte përkthyer fjalinë e fundit të z. Thaçi,
5 të deklaratës së z. Thaçi ku ai tha që nuk mund të
6 nënshkruante.

7 Dr. Williams, kërkoj ndjesë që jam pak i gjatë por po ju
8 kujtoj pak më shumë saktësi, po a ju kujtohet nëse z. Thaçi --
9 çfarë tha z. Thaçi saktësisht? A tha ai që nuk ishte i
10 autorizuar të pajtohej me propozimin apo tha që nuk mund të
11 nënshkruante marrëveshjen?

12 PË. Vetoni përktheu në anglisht atë që Thaçi kishte thënë në
13 shqip. Mund t'ju jap kontekstin e këtyre 12 minutave që
14 rëndësishëm, pra, dramatik në qoftë se dëshironi.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Përgjigjuni pyetjes sime së
16 pari.

17 PË. Nuk më kujtohen konkretisht fjalët që përdori Vetoni,
18 përveçse -- pra, nuk më kujtohen fjalët konkrete që Vetoni
19 përdori. Vetoni po përkthente deklaratën e Hashimit për pikat
20 që -- ndërhyrja e Vetonit ishte të theksonte se edhe, këtu
21 fjalë për fjalë po them, "Kujdes, kujdes, kujdes. Znj.
22 Sekretare, sapo u keqinformuat", arsye, në qoftë se mund të
23 vazhdoj -- Abramowitz dhe unë e dinim që përgjigja ishte jo.
24 Kjo ishte në kokën time, kur hynë brenda Albright dhe Chris
25 Hill. Dhe biseduan me Rugovën, shkëmbyen, për pavarësi do them

-- në qoftë se do na japin një pavarësi do themi po. Pastaj pyetën Qosjen edhe e njëjta gjë në qoftë se na jepni pavarësi them jo. Pastaj pyetën Thaçin, shkëmbyen disa fjalë dhe përkthyesi ngriu në fjalinë e fundit nuk tha asgjë. Pastaj aty znj. Albright filloi t'i përgëzonte, pra, të gëzohej për këtë. Dhe aty qëllimi i vetëm i Vetonit ishte: Znj. Sekretare, ju lutem ndaloni, ndaloni një sekondë. Përkthyesi nuk përktheu atë, faktin që nuk kishte pëlqim apo marrëveshje për të nënshkruar këtë, nuk kishte dakordësim.

Kjo është aq i saktë sa mund të jem.

GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju faleminderit. Në paragrafin 39 të deklaratës suaj, ju thatë që i thatë Mbrojtjes që nuk ishit habitur që z. Thaçi tha apo bëri me dije siç thuhet edhe këtu që nuk e kishte autoritetin dhe që nuk mund të nënshkruante në emër të UÇK-së dhe që ju ishit, ju nuk prisnit qëndrimet e kufizuara të z. Thaçi duke pasur parasysh statusin e tij që të ishte në gjendje të angazhohej në emër të komandantëve apo të fliste në emër të komandantëve vendorë të UÇK-së pa marrë paraprakisht pëlqimin e tyre.

Dhe këtu kërkoj ndjesë që po ju kërkoj më shumë hollësi, po është e rëndësishme. A ju kujtohet nëse z. Thaçi shprehimisht tha që ai duhet të merrte pëlqimin e komandantëve rajonalë dhe lokalë përpara se të ishte në gjendje të nënshkruante marrëveshjen? A e tha këtë gjë?

PË. Po përpigem të kujtoj nëse ai e tha këtë gjë konkretisht

1 mua ose delegacionit, apo nëse ishte përshtypje nga bisedimet
2 shumë dimensionale dhe të tërësishme që u krijuan pra.
3 Përshtypja ime, si jurist ndërkombëtar, është që Hashimi nuk
4 ka thënë "Paul, jurist nuk mund ta shkruaj këtë, sepse X, Y,
5 ai tjetri kanë thënë jo. Nuk mund të bëj gjë pa ata". Asnjë
6 prej klientëve të mi nuk do ta thonte një gjë të tillë. Por
7 arsyet për të mos nënshkruar dhe shpeshherë punojmë me aktorë
8 të armatosur jo shtetëror thonë, "Në rregull, nuk mund ta
9 shkruaj për këtë, për këtë, duhet që kjo të ndryshojë, duhet
10 që ajo të ndryshojë". Nuk parasheh pavarësinë dhe për
11 rrjedhojë nuk mund të nënshkruaj.

12 Dhe me thirrje telefonike, bisedat që bëhen me diasporën,
13 fakti që unë u bëra juristi, këshilltari ligjor i Hashimit
14 ishte sepse një copë letër që dikush jashtë, i cili mund të
15 ishte komandant vendor, tha, "Mund t'i besosh këtij. Ky
16 juristi yt". Tani kjo nuk do të thotë që ata kishin kontroll,
17 ushtronin kontroll ndaj tij, pra, konkret, por ai nuk ishte që
18 thoshte "Jo. Je s'është kjo punë, ti je person që ke punuar me
19 Bukoshin. Largohu". Ai tha, "Në rregull. Ulu këtu. Hajde
20 shkojmë e bëjnë një ecje në këmbë dhe bisedojmë". Pra, këto
21 ishin gjëra që ma kanë krijuar këtë përshtypje. Faktik që nuk
22 më largojë edhe pse kisha punuar për Bukoshin. Pra, komenti i
23 asokohe i David Wilson për KVM-në ishte që kontrollonte, pra,
24 këshillin vendor.

25 Por nuk mund të thoshte që "këta pesë persona", që më

1 kanë marrë mua për kafe, "më kontrollojnë apo që" -- po kjo
2 ishte përshtypja ime e qartë në atëkohë.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dr. Williams, do t'ju pyes
4 tani si jurist, nga pikëpamja e juristit, a e dini nëse
5 pëlqimi i komandantëve, i komandantëve rajonalë të UÇK-së
6 kërkohet në mënyrë formale, me fjalë tjera, a jeni në dijeni
7 të ndonjë dispozite apo rregulli që kërkonte që z. Thaçi
8 pikësëpari duhej të konsultohet me komandantët vendorë dhe
9 pastaj të kërkonte edhe të merrte miratimin e tyre?:

10 PË. Nuk kam qenë në dijeni të kësaj. Përgjigja ime është jo,
11 nuk kam qenë në dijeni. Dhe do të isha habitur shumë nëse do
12 të kishte ekzistuar diçka me shkrim, pra, e shkruar. Pra,
13 është një strukturë rurale mbi bazat rurale, nuk ju vjen në
14 mendje mendoj ky nivel ndërveprimi dhe do të kishte qenë shumë
15 më normative, më kulturore, më me pushtet, me autoritet dhe më
16 shumë më pak e bazuar në rregulla, nëse kjo ka kuptim për ju.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

18 Dhe pika e fundit. Përmendet në këtë kontekst, përmendet
19 në nivelin e lartë të stresit emocional dhe gjithashtu -
20 gjendet në faqen 87 të transkriptit të djeshëm - presioni
21 kulturor dhe ideologjik, mendoj që kjo ishte në lidhje me z.
22 Demaçi, pra, presioni ideologjik dhe kulturor. Përveç
23 presionit apo stresit a e dini nëse z. Demaçi ishte në mënyrë
24 të drejtpërdrejtë apo të tërthortë i kërcënuar gjatë bisedimet
25 e Rambujesë qoftë nga delegacioni apo nga dikush jashtë

1 kështjellës? A keni ndonjë informacion lidhur me këtë?
2 PË. Tani do të bëj një humor duke thënë që Madeleine Albright
3 e kërcënoi atë që të mbyllte kufirin dhe të bënte gjëra tjera.
4 Në qoftë se mund ta përshkruajë këtë në këtë mënyrë është për
5 t'ju përgjigjur pyetjes tuaj me saktësi pastaj të jap edhe
6 kontekstin në qoftë se më lejohet.

7 Unë nuk jam informuar në mënyrë konkrete që personi X ka
8 bërë kërcënime. Unë kam perceptimin e stresit dhe të
9 kërcënimit të mëngjesit të datës 8 kur isha aty, francezët
10 dërguan një protokoll tipik, një fotograf për të bërë
11 fotografi tipike, klasike të protokollit. Ky fotograf gati i
12 prishi negociatat e Rambujesë se ai u fut në dhomën ku ishte
13 delegacioni, bëri fotografi të Hashimit dhe Rugovës dhe
14 tjerëve dhe Hashimi u nervozua shumë totalisht. Ai nuk e
15 dinte, Hashimi u bë shumë i nervozuar dhe i stresuar sepse
16 fotografitë e tij në kështjellën ku bëheshin negociatat do të
17 përdreshin në një farë mënyre nga Serbia për ta shenjëstruar
18 atë. Nuk e di saktësisht sesi e bëri këtë lidhje.

19 Ky ishte thjesht një fotograf i zakonshëm që në dhomën ku
20 ishte delegacioni përveç nëse Albright, Cook apo Vedrine --
21 nuk kishte fotograf, rrallë shumë mund të kishte fotograf në
22 dhomën e delegacionit përveç rasteve ku aty ishte Albright,
23 Cook apo Vedrine. Por ky nivel ankthi dhe nervozizmi lidhur me
24 sigurinë personale për shkak të një fotografi të protokollit,
25 i cili ishte francez dhe mori këtë fotografi, bëri këtë

1 fotografi.

2 Ndodhi kishte një nivel ankthi dhe stresi sepse ai kishte
3 mbajtur këtë pozitë si kryesues i delegacionit që e kishte
4 bërë atë kishte sjellë në vëmendje më të madhe për sa i takon
5 forcave të sigurisë serbe ndaj tij.

6 Dhe në kontekstin më të gjerë, më ndaloni në qoftë se e
7 kam gabim, më shumë se 12 klientë *pro bono* për të cilët kam
8 punuar në negociata janë vrarë nga ana tjetër. Pra, frika që
9 të jesh negociator dhe të shenjëstrohesh nuk është e
10 pavërtetë, nuk frikë e pabazuar. Pra, pastaj ju konsideroni
11 siç është, siç e mendoni ju. Por kishte një ndjenjë që mund
12 përforcohej shenjëstrimi, pra, të vihej një shenjështër mbi
13 shpinën tuaj duke qenë kryesuesi i grupit negociator dhe duke
14 luajtur rol kyç dhe të rëndësishëm në negociata.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po sa u takon, lidhur me
16 pjesëtarët e tjerë të delegacionit, e kam fjalën Rugova dhe ai
17 ishte person që ishte i njohur gjerësisht dhe anëtarët e
18 tjerë, z. Surroi edhe ata u bënë me nerva apo u nervozuan apo
19 siç e thatë ju që ndodhi me atë?

20 PË. Më pak lidhur me fotografimin sepse ata ishin Rugova,
21 Vetoni, Bukoshi, ishin më rehat me protokollin. Bukoshi kishte
22 dhënë, kishte bërë intervista për media më herët. Kur Bukoshi
23 shkonte në Capitol Hill, në Amerikë, personat e stafit bënë
24 fotografi dhe e nxirrnin në kamera, e filmonin dhe ai ishte në
25 rregull me këtë, nuk kishte ndonjë problem.

1 Tani, thënë këtë Rugova kishte një lloj pozicioni që
2 ishte shkëputur nga kjo. Dhe Departamenti i Shtetit, do ta
3 qartësoj se çfarë e kam fjalën kur them këtë, për çfarë e kam
4 fjalën. Departamenti i shtetit e bëri të qartë Milosevic,
5 Rugova nuk preket. Dhe nëse forcat serbe do të bënin diçka
6 Rugovës kjo do të kishte qenë vija, një lloj vijë e kuqe që nuk
7 duhej të kalohej. Pra, Bukoshi ishte i vendosur në Gjermani.
8 Vetoni rrinte në Prishtinë gjatë fushatës së bombardimeve
9 ajrore dhe kishte përpjekje intensive për t'u përpjekur të
10 siguronte mbështetjen e Vetonit dhe shokëve të tij nga
11 ndërkombëtarët. Dhe përpjekje intensive që të dërgoheshin
12 mesazhe Milosevic. Mos prekni Vetonin. Vetoni nuk preket. Do
13 të thotë mos dërgoni forcat e MUP-it që ta merrni atë dhe nga
14 aty ku është i fshehur në Prishtinë.

15 Edhe këtu kjo është jashtë kontekstit të *chateau*, por
16 Hashimi ishte i vetmi që kishte nivel stresi në këtë pikë në
17 këtë kohë dhe kishte arsye pse Bukoshi, pse Rugova dhe Bukoshi
18 ishin më të izoluar apo më imunizuar nga stresi në atë pikë.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Dr. Williams.
20 Tani do të shkoj tek pyetjet e mia të fundit.

21 Dje, ju diskutuat me Mbrojtësin e z. Thaçi dispozitën që
22 ju keni hartuar në Rambuje për delegacionin shqiptar të
23 Kosovës që thuhej që "të gjithë palët në këtë marrëveshje të
24 bashkëpunojnë tërësisht në mënyrë të plotë me TPNJ-në", me
25 Tribunalin Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Ju kujtohet që

1 keni thënë këtë?

2 PË. Po.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Apo që e keni biseduar,
4 diskutuar këtë?

5 PË. Po.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe në qoftë se nuk gaboju,
7 ju keni konfirmuar që ishe e qartë për të gjithë anëtarët e
8 delegacionit, përfshirë z. Thaçi që ky propozim do të
9 përfshinte bashkëpunimin e plotë në arrestimin dhe
10 transferimin e pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
11 në TPNJ dhe mbledhjen, grumbullimin e provave kundër
12 pjesëtarëve të UÇK-së?

13 PË. E saktë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dr. Williams, a e dini nëse
15 UÇK-ja dhe/ose Qeveria e Përkohshme e Kosovës më vonë në fakt
16 dhe në të vërtetë bashkëpunuan në mënyrë të plotë dhe të
17 tërësishme me TPNJ-në dhe mbledhën prova dhe arrestuan dhe
18 transferuan pjesëtarë të UÇK-së që dyshoheshin se kishin kryer
19 krime lufte apo krime të tjera që ishin pjesë, përfshiheshin
20 në juridiksionin e TPNJ-së dhe në qoftë se po a mund të na
21 jepni shembuj të këtyre gjërave?

22 PË. Tani në këtë çast nuk më kujtohet nëse ka patur, ky lloj
23 bashkëpunimi ka ndodhur, apo jo, pra nuk jam në gjendje, nuk
24 dëshiroj të spekuloj.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime e fundit. A jeni

1 në dijeni të rasteve ku të dyshuar nga Ushtria Çlirimtare e
2 Kosovës janë arrestuar dhe transferuar UNMIK-ut ose KFOR-it në
3 1999?

4 PË. Kam dijeni për këtë, kam dijeni se shqiptarët e Kosovës
5 kanë dalë përpara Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-
6 Jugosllavinë bazuar në aktakuza të ngritura. Nuk më kujtohet
7 konkretisht tani në këtë çast sesi kanë përfunduar atje.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Këto ishin
9 pyetjet e mia.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
11 Mettraux.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
13 Smith.

14 Mirëmëngjes, Doktor. Kam disa pyetje.

15 Do të filloja duke ju pyetur, duke bërë disa pyetje
16 lidhur me Bujar Bukoshin. Dhe nga ajo që thatë dje kuptoj që
17 ju keni thënë që ju e konsideronit atë jo vetëm klient por një
18 person për të cilin kishit respekt. Është e saktë?

19 PË. E saktë.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në përgjithësi a ishit në
21 dijen për pikëpamjet politike që mbështeste z. Bukoshi?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Si do t'i karakterizonit
24 këto pikëpamje, këto qëndrime?

25 PË. Pikëpamjet politike, qëndrimet politike të Bujar Bukoshit

1 ish-in, përputheshin 100 për qind me pikëpamjet Presidentit
2 Rugova, pra, pavarësi për Kosovën me nuancën që procesi, pra,
3 pavarësia apo vetëvendosja nga jashtë është një proces. Pra,
4 të njëjtat pikëpamje politike si Rugova por nuanca apo
5 dallimet e vogla kishin të bënin me procesin për të arritur
6 këtë dhe po ashtu më i nuancuar lidhur me nevojën për të
7 punuar me partnerët ndërkombëtarë dhe aleatët, qeveritë dhe
8 dimensionet e qeverive që të ndodhte kjo gjë, pavarësia.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani si do t'i krahasoni
10 këto pikëpamje me ato të udhëheqjes së UÇK-së, në qoftë se
11 është e mundur?

12 PË. Pikëpamjet e udhëheqjes së UÇK-së pasqyronin pikëpamjet e
13 presidentit Rugova - që është pavarësia - por më pak të
14 nuancuara se pikëpamjet e Bujar Bukoshit sa i takon faktit që
15 vetëvendosja do të ishte një proces dhe që ky proces do të
16 ishte proces politik po njëkohësisht dhe një proces i lidhur
17 me lëvizjen e armatosur. UÇK-ja duke patur parasysh origjinën
18 e saj në fshatra ishte më aktor, kishte një qasje të një
19 aktori të armatosur jo shtetëror më të thjeshtë apo më të
20 thjeshtësuar për sa i takon pavarësisë: Është qëllimi jonë, ne
21 jemi viktimë të krimeve mizore dhe duhet të arrijmë diçka
22 shpejt, na duhet diçka shpejt që të arrijmë pavarësinë.

23 Duhet të jem i kujdesshëm këtu. Megjithatë këto pikëpamje
24 pastaj evoluon, ndryshuan gjatë verës, pjesës së tetorit dhe
25 një pjesë të Rambujesë. Unë e kam parë këtë, e kam konstatuar

1 këtë gjë me shumë aktorë të armatosur jo shtetëror me të cilët
2 kam punuar sesi futen në proces dhe ka këto momentet e vogla
3 që në këtë kuptim pra, që e rrisin lëvizjen së bashku.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni nëse
5 partia politike e z. Bukoshi -- cilës parti politike i
6 përkiste z. Bukoshi? LDK-së?

7 PË. LDK-së

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a është e vërtetë që
9 dhe pjesëtarët e tjerë të qeverisë së tij në ekzil i përkisnin
10 kësaj partie?

11 PË. Mesa kuptoj unë, po. Kuptoj që të gjithë pjesëtarët e
12 qeverisë, anëtarët e qeverisë në ekzil ishin LDK.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe nga ajo që kemi
14 dëgjuar nga ju dje, a është e saktë që të sugjerojmë që ju
15 keni patur një -- keni kuptuar mirë, keni kuptuar në një
16 shkallë të mirë dinamikën politike që ekzistonte në Kosovë në
17 1998, 1999. A pajtoheni me këtë?

18 PË. Më bëhet shpesh kjo pyetje dhe përgjigja ime do të ishte
19 ndoshta që kisha një kuptim të situatës atje në një nivel 70,
20 75 për qind, për shkak se isha juristi i tyre *pro bono* dhe
21 kisha qasje në informacione. Por duke qenë nga Kalifornia, nuk
22 jam shqiptar, nuk jam kosovar dhe nuk është se kisha qasje në
23 të gjitha gjërat që ishin të besueshme dhe apo konfidenciale.
24 Pra, pra, nuk mund ta mbivlerësoj këtë njohuri që kisha apo ta
25 ekzagjeroj, pra, do thoja 70 për qind në qoftë se kjo i

1 përgjigjet pyetjes tuaj.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kjo i përgjigjet shumë
3 mirë, zotëri. Tani në kontekstin se si karakterizuat
4 marrëdhënien midis nga njëra anë z. Bukoshi, kryeministrit,
5 dhe qeverisë së tij dhe nga ana tjetër udhëheqja e UÇK-së
6 gjatë vitit 1998 deri në Rambuje dhe më vonë, si do ta
7 karakterizonit këtë?

8 PË. Do ta karakterizoj atë - do të ecë ngadalë për
9 përkthyesit - sepse mendoj se ishte njëkohësisht e tendosur
10 dhe intensive.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani dhe juve ju bën
12 pyetje lidhur me faktin nëse ju ishit në dijeni të tensioneve,
13 ju sapo e përdorët këtë fjalë, këtë shprehje apo problemi
14 midis Bukoshit dhe komandantëve të UÇK-së. Dua t'ju pyes nëse
15 keni qenë ndonjëherë në dijeni të këtyre tensioneve apo
16 problemeve mes tyre qoftë përpara apo pas Rambujesë?

17 PË. Natyra - t'ju tregoj një histori? Dhe besoj që i
18 përgjigjet pyetjes, sepse kjo është mënyra sesi shqiptarët --
19 kjo është mënyra sesi Bukoshi është marrë me mua më ka
20 trajtuar mua dhe ka trajtuar tensionin që kishte.

21 Kur arrita në Paris, u përshëndeta nga Bujar Bukoshin. Ai
22 shkoi në kështjellë më 7.00. Unë shkova atje më 8.00. Tavolina
23 ka këtë formë. Ne ulemi këtu, UÇK-ja këtu, kryesuesi këtu,
24 ekspertët këtu. Unë hyra brenda dhe thashë dhe doja të ulesha
25 afër Bujar Bukoshit ndaj ai vuri dorën në karrigen ku unë

1 kisha qëllimin të ulesha dhe ai më tha, "Mos u ul afër meje,
2 se pastaj je juristi im. Shko ulu diku tjetër dhe ndërro
3 karriget çdo ditë". Dhe kjo ishte mënyra e tij për të më thënë
4 mua që: Në qoftë se je jurist i delegacionit, ata kanë një ide
5 një perceptim për mua - Bukoshit - ka tensione me mua -
6 Bukoshin - dhe në qoftë se shikohesh e konsiderohesh si person
7 që punon për mua, është mirë për mu, por s'është mirë as për
8 ty, as për delegacionin.

9 Pra, me gjithë marrëdhëniet intensive dhe të tendosura,
10 protokolli, kultura e njeh këshilltarin ndërkombëtar ishte:
11 Mos e merr atë ti.

12 Dhe më kujtohet herën e parë jam ul -- nuk e bëra këtë
13 ditën e parë, por u ula ditën e parë me UÇK-në, delegacionin e
14 UÇK-së. Dhe kur shkova aty Jakup Krasniqi tërhoqi karrigen
15 afër tij që unë isha i ftuar të ulesha afër tij. Ata e dinin
16 që unë kisha punuar me Bukoshin, që kisha marrëdhënie të
17 ngushtë me Bukoshin, absolutisht e qartë. Por për marrëdhënien
18 time ishte e rëndësishme që kjo të mos bëhej pjesë e këtyre
19 tenseioneve.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Mendoj që
21 keni fituar të drejtën që të bëjmë një pushim në këtë moment.

22 DËSHMITARI: Në rregull.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca

1 ndërpritet për një pushim deri në orën 10.10.

2 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

3 --- Seanca rifillon në orën 10:10

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim].

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të vijojmë
7 tani me dëshminë tuaj, do të vazhdoj me pyetjet e Gjykatësve.
8 Jo, kundërpjetet, se thashë gabimisht kundërpjetet, janë
9 pyetjet e Gjykatësve.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe një herë mirëmëngjes.

11 PË. Mirëmëngjes.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do flasim pak në hollësi,
13 po fillimisht një pyetje të përgjithshme. A keni dijeni për
14 disa deklarata publike që janë bërë prej udhëheqësve të UÇK-së
15 në 1998 dhe 1999 lidhur me z. Bukushi apo qeverinë e tij?

16 PË. Më kujtohet se një nga dimensionet të marrëdhënieve të
17 tensionuara dhe të patensionuara kanë qenë përpjekjet e UÇK-së
18 për të krijuar hapësirë politike duke e bërë të paligjshme
19 LDK-në, deri në një farë shkalle, që është krejt normale, por
20 veçanërisht Bujar Bukoshin sepse ai ishte kryeministri, për
21 shkak se ai ishte jashtë Kosovës dhe për shkak se ishte në një
22 shkallë të madhe figura, imazhi publik.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A ju rikujtohet në këtë
24 aspekt të kenë dalë disa deklarata të vazhdueshme në 1998, më
25 duket se dhe në 1999, deklarata nga udhëheqja e UÇK-së që

Dëshmitari: Paul Williams (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 37

1 kërkonin nga Bujar Bukoshi dhe qeveria e tij të siguronin
2 fonde që sipas udhëheqësve të UÇK-së Bujar Bukoshi i kishte në
3 dispozicion?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në vlerësimin tuaj ka qenë
6 kjo pjesë, ka qenë kjo një arsye për shkak të tensioneve që
7 kanë pasur ata për të cilat folët pak më herët?

8 PË. Po. Po do të jap pak më shumë kontekst, nëse më lejoni.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Patjetër.

10 PË. LDK-ja ka qenë efektive në grumbullimin e fondeve prej
11 diasporës. Dhe ndonëse Bukoshi nuk i kontrollonte këto fonde,
12 ai ishte pjesë e ekipit të LDK-së që bënte kontrollin e
13 fondeve. Në mënyrë të vazhdueshme kishte kërkesa prej
14 komunitetit shqiptar, qofshin këta refugjatë apo aktorë të
15 tjerë apo qoftë dhe UÇK-ja, kërkonin që këto fonde të
16 shpenzoheshin në një mënyrë të caktuar. Për shembull, UÇK-ja
17 sikurse dhe disa të tjerë mund të thoshte, "Prit, keni kaq
18 para në dispozicion. Ne na nevojitet X shumë. Kështu që pse
19 nuk na i jepni këto?". Në qoftë se dikush ka 100 dollarë, a ka
20 100.000 dollarë. Unë nuk e di sa para kishte LDK-ja
21 konkretisht, këtë nuk mund t'jua them.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Për procesverbal dhe që ta
23 kuptojnë dhe palët dua të theksoj provën materiale P284,
24 provën materiale 270.15, provën 578, 579, 271 dhe 515.17.

25 A u informuat të ketë pasur ndonjë hezitim nga ana e

1 Bujar Bukoshit që të ofronte ndihmë financiare për UÇK-në siç
2 i kërkohej?

3 PË. Po. Bujar Bukoshi ishte hezitues, hezitonte të ofronte
4 ndihmë financiare për UÇK-në.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mund të na e thoni pse?

6 PË. Burimet që kishte mbledhur diaspora ishin të kushtëzuara,
7 ishin mbledhur që të financonin sistemin arsimor paralel që
8 funksiononte në Kosovë dhe të financonin kujdesin shëndetësor
9 paralel. Pra, do ju jap një përgjigje pak më të gjerë. Ne kemi
10 folur shkurtimisht për këtë kur vjen çështja e parave dhe
11 armëve, unë nuk mund të flas. Unë mund të flas për të drejtat
12 e njeriut.

13 Megjithatë, ai më ka thënë që ka dy probleme. "I kemi
14 mbledhur këto para nga diaspora për shëndetësinë dhe për
15 arsimin dhe këtu duam t'i shpenzojmë". Dhe besoj se i
16 përdornin dhe për disa nga refugjatët. Dhe, së dyti, por mos
17 ma merrni përfundimtare këtë, së dyti, nëse doni para për armë
18 ka forma të tjera për ta bërë këtë. Dhe përfundimisht, në
19 fakt, e gjetën një zgjidhje.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, ju thoni që z.
21 Bukoshi apo qeveria e tij hezitonte të ofronte ndihmë me
22 armët, nuk donin të ofronin ndihmë për armatim apo ishte diçka
23 tjetër?

24 PË. Unë do ju thoja që ai hezitonte për shkak të natyrës
25 konkurruese politike dhe sikurse ua thashë, fonde të

1 kushtëzuara -- mos e merrni kaq të mirëfilltë, për shkak se ky
2 është një term amerikan, ishin fonde që ishin caktuar për
3 diçka tjetër dhe do të ishte e papërshtatshme t'i përdornin në
4 një fushë tjetër, kur nuk ishin caktuar për atë fushë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani do të shohim disa
6 dokumente dhe do të doja të më ndihmonit nëse mundeni.

7 Do i lutem Zyrës Administrative të nxjerrë në ekran
8 provën materiale P310.

9 Po ju jap një çast të njiheni me dokumentin në ekran. Do
10 ta përshkruaj qoftë për procesverbal. Pretendohet ose mendohet
11 që kjo është një deklaratë publike nga Hashim Thaçi si
12 udhëheqës i drejtorisë politike pranë Shtabit të Përgjithshëm
13 të UÇK-së dhe është botuar tek Zëri i Kosovës të enjten, më 28
14 janar 1999. Më duket se ka diçka tjetër në faqe, po nuk është
15 shumë relevante për ju, që intervista ose ë marrë ose është
16 zbardhur më 18 janar të 1999. E shihni këtë?

17 PË. Po.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Fillimisht a e keni ditur
19 ju që z. Thaçi në janar të 1999-s është prezantuar si
20 udhëheqës i drejtorisë politike të Shtabit të Përgjithshëm të
21 UÇK-së?

22 PË. Jo.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e dini apo a e dinit
24 asokohe që ai ndonjëherë fliste me median pavarësisht në çfarë
25 cilësie e bënte këtë?

1 PË. Jo mesa më kujtohet, jo.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po për këtë gazetën Zëri i
3 Kosovës e njihni këtë gazetë?

4 PË. Po.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të themi që është
6 një gazetë, që ka qenë në favor mund të themi të UÇK-së
7 asokohe?

8 PË. Kjo nuk më kujtohet konkretisht.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'i lutem Zyrës
10 Administrative të shkojmë më poshtë në dokument.

11 Edhe, Dr. Williams, nëse doni ta lexoni dokumentin, ju
12 lutem më thoni.

13 Fillojmë me paragrafin që fillon me fjalët "Deklaratat e
14 fundit nga 'qeveria' Bukoshi ..."

15 PË. Paragrafin e parafundit?

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po. Po e lexoj për
17 transkript:

18 "Deklaratat e fundit nga 'qeveria' e Bukoshit janë tepër
19 acaruese, të anshme dhe ofenduese, duke mbajtur parasysht çka
20 ka ndodhur në Kosovë dhe më gjerë dhe janë të pavërteta, janë
21 të mbushura me shantazhe madje dhe me kërcënime."

22 Pyetja ime e parë është kjo: Keni dijeni se për çfarë
23 deklaratah e ka pasur fjalën z. Thaçi këtu në mes të janarit
24 1999?

25 PË. Jo, nuk kujtohet konkretisht se për çfarë deklaratah

1 bëhet fjalë. Po nëse më lejoni, po mbase këto pasqyrojnë
2 sjelljen e Bukoshit ndaj kërkesave të UÇK-së që nuk ua merrte
3 parasysh. Nuk e di konkretisht, po nuk më befason që të jetë
4 shprehur në këtë formë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më tej thotë:

6 "Qeveria Bukoshi nuk e ka njohur dhe nuk e ka mbështetur
7 siç Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës".

8 Shkojmë në faqen tjetër.

9 "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk ka njohuri për mjetet
10 e mbledhura në emër të luftës se në ç'drejtime janë dedikuar.
11 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së fton bashkatdhetarët që të mos
12 bien në grackat e konstruktura nga 'institucionalistët'."

13 Po ndaloj këtu për një çast. Si e kuptoni ju termin
14 "institucionalist" ose sipas jush për kërkoj bëhej fjalë.
15 PË. Kjo nuk është një fjalë apo një term që e kam dëgjuar
16 gjatë kohës që kam punuar me shqiptarët e Kosovës. Ata thonin
17 LDK-ja. E përmendnin LDK-në apo të tjerë. Kështu që nuk dua të
18 hamendësoj, nuk dua të supozoj. Nuk mund të them që "Ah, për
19 këtë e kanë fjalën, nuk e njoh si term".

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A kishte institucione në
21 atë kohë parlament, presidencë?

22 PË. Kishte, ekzistonin pjesërisht në Kosovë dhe pjesërisht
23 jashtë Kosovës. Presidenti Rugova qëndronte në Kosovë.
24 Kryeministri Bukoshi qëndronte në Gjermani. Edita Tahiri,,
25 ish-ministra e jashtme qëndronte po ashtu në Kosovë. Ministria

1 e Shëndetësisë, e arsimit funksiononin po ashtu në Kosovë, po
2 ka pasur një komunikim të ngushtë me diasporën. Kishte qeveri
3 paralele, disa ishin në Kosovë, disa nuk ishin në Kosovë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Artikulli vijon më tej, të
5 paktën sipas kësaj interviste thuhet:

6 "Nga ana tjetër, sa u takon kontributit të tyre financiar
7 që mbajnë të ngrira, të bllokuara t'u bëjnë presin
8 'institucionalistëve' që ato të derdhen në fondin e UÇK-së
9 'Vendlindja Thërret' ..."

10 S'po ua them dot në shqip. E njihni këtë fondin
11 Vendlindja Thërret?

12 PË. Jo, nuk e kam njohur fondin Vendlindja Thërret
13 konkretisht.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po a u informove më vonë
15 lidhur me të?

16 PË. Jo. E di që ngriheshin fonde për UÇK-në, po emrin e
17 organizatës apo të fondit nuk e di.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Vazhdon më tej thotë:

19 "Bukoshi duhet të qartësojë para popullit dhe
20 bashkatdhetarëve të nderuar që nuk kursyen e nuk po kursejnë
21 edhe kafshën e gojës ta ndajnë për UÇK-në, ku janë ato mjete
22 dhe për çka shfrytëzohen.

23 "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka dhëna të sigurta që
24 janë keqpërdorur rreth 100 milion marka gjermane nga ju dhe
25 suita që ju rrethon (60 milion më në fund pranuat se janë

1 shpenzuar, 10 milion dollarë vetëm në emër të një kontrate të
2 dështuar) 'në shërbim të popullit'. Këto para janë përdorur
3 nga ju për të financuar të gjithë ministrinë e brendshme. Ju
4 keni financuar në vrasjen dhe tentim vrasjet e komandantëve të
5 UÇK-së, dosja juaj flet për planet tuaja për likuidimin e
6 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe disa personaliteteve
7 eminente të skenës kosovare."

8 Mesa keni ju dijeni, a ka ndonjë të vërtetë, në dijeninë
9 tuaj, në ndonjë prej pretendimeve që janë në këtë artikull?
10 PË. Jo në dijeni time, nuk mund të them a ka të vërteta në
11 këto akuza, në këto pretendime, kaq. Këto janë komunikime që i
12 kam dëgjuar nga shqiptarët, nga diaspora shqiptaro-amerikane
13 por jo domosdoshmërisht të vërteta. Po jua jap për kontekst,
14 kemi një situatë të tensionuar. Të gjithë mendojnë që Bukoshi
15 ka shumë para në dispozicion. Këto para duhet të përdoren për
16 këtë e për këtë gjë. Sigurisht që ka tensione nga aktorët jo
17 shtetëror të armatosur dhe revolucionit. Besoj se ua bëra të
18 qartë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të vijojmë me një
20 pyetje tjetër. Ju thatë më herët që e kuptoni me 70 për qind
21 dinamikën e asokohe, deklarata të këtij lloji, veçanërisht
22 fakti ku thuhet që z. Bukoshi ka qenë i përfshirë në vrasjet e
23 tentim vrasjesh, këto akuza apo pretendime a nuk e dëmtonin
24 imazhin e Bukoshit dhe të qeverisë së tij?

25 PË. Këto akuza, mua -- në fakt, jam më komod me pjesën e parë

1 të paragrafit kur thanë që "kanë burime të konsiderueshme nga
2 diaspora, nuk po i shfrytëzojnë siç duhet" dhe diçka që unë
3 nuk besoj se është e vërtetë, mund të jetë bërë edhe për të
4 dëmtuar imazhin e tyre.

5 Deklarata e dytë që ka financuar vrasjet e tentim
6 vrasjesh më duket si komunikim i pabazuar për shkak të
7 personalitetit të Bujar Bukoshit dhe qasjes së tij. Ky është
8 mendimi im dhe perceptimi im.

9 Nuk e di a ju dhashë përgjigje?

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po. Faleminderit.

11 I lutem Zyrës Administrative të nxjerrë në ekran provën
12 P4166.

13 Po ju jap një çast që ta lexoni dokumentin. Fillon me
14 deklaratën politike, data 17 janar 1999. Është po ashtu e
15 botuar tek Zëri i Kosovës, data është e enjte, 21 janar 1999.

16 Do i lutem Sekretarisë të shkojë më poshtë në tekst.
17 Faleminderit.

18 Këtu sipas këtij artikulli kjo është një intervistë me
19 Jakup Krasniqin, i cili këtu është prezantuar si përfaqësues
20 politik i UÇK-së dhe zëdhënës. A e shihni këtë përfaqësues
21 politik dhe zëdhënës i UÇK-së?

22 PË. Po.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem, shikoni pyetjen
24 ku është poshtë emrit "Adnan Asllani".

25 PË. Zëri i Kosovës ..."

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po. Po e them për
2 procesverbal dhe pastaj do t'ju bëj pyetje për këtë. Gazetari
3 bën këtë pyetje:

4 "Z. Jakup, në një deklaratë të qeverisë të Bukoshit të
5 emetuar më 17 janar 1999, nga TVSH-ja 'qeveria', thuhet se e
6 ashtuquajtura qeveri paska ndihmuar Kosovën me 60 milion marka
7 gjermane. A i ka ardhur diçka nga këto mjete UÇK-së?"

8 Sipas këtij teksti Jakup Krasniqi është përgjigjur
9 kështu:

10 "Bukoshi mund t'i bjerë vetes mbi shpatulla për këtë term
11 të përkufizuar si 'kryeministër', pra, të lavdërohet për
12 postin e pakufishëm të 'kryeministrit', për shpenzimet e
13 pakontrolluara të shpërdoruara. Nuk e di sa marka gjermane ka
14 çuar nëpër miq e jarana nëpër xhepat e tyre, por them me
15 bindje se në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të
16 Kosovës nuk ka ardhur asnjë markë gjermane."

17 Pyetja ime e parë është kjo -- ju lutem gjithmonë çfarë
18 dini. Në qoftë se nuk e dini thoni që nuk di gjë. Pra, keni
19 dijeni ju që z. Bukoshi dhe qeveria e tij të kenë shpërdorur
20 paratë që ka marrë nga diaspora apo nga të tjerët?

21 PË. Jo, nuk jam në dijeni që qeveria e Bukoshit të ketë
22 shpërdorur fondet e diasporës, ti ketë përdorur për përfitime
23 personale.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ky pretendimi që z.
25 Bukoshi apo qeveria e tij nuk i kanë dhënë asnjë ndihmë

1 financiare UÇK-së, sipas jush është e vërtetë, e rreme apo nuk
2 e dini?

3 PË. Nuk di të jetë e vërtetë, kaq. Mund t'ju jap një
4 përshtypjen time nëse ju shërben.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

6 PË. Nuk befasohesha nëse do të ishte e vërtetë, duke mbajtur
7 parasysh marrëdhënien e tensionuar dhe intensive të Bujar
8 Bukoshit.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pyetja e dytë është kjo,
10 po nga gazetari:

11 "Ku kanë shkuar atëherë këto mjete?"

12 Sipas këtij teksti përgjigja e z. Krasniqi ka qenë kjo:

13 "Një pjesë e di që ka shkuar për dobësimin e aftësive
14 mbrojtëse të UÇK-së duke financuar dezertorë të luftës."

15 Edhe një herë bazuar në atë çka dini apo mund të keni
16 diskutuar me z. Bukoshi, sipas jush ka ndonjë të vërtetë në
17 këtë pretendim, në këtë deklaratë?

18 PË. Nuk e di a të ketë ndonjë të vërtetë në këtë. Kjo është
19 një deklaratë që unë s'e kam dëgjuar ndonjëherë më përpara.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Lirisht mund të thoni që
21 nuk di asnjë më shumë. Por me sa keni ju dijeni apo nga
22 kontaktet e ngushta me z. Bukoshi, ju mendoni se ai ishte një
23 person që ishte në gjendje ta bënte këtë?

24 PË. Keni fjalën të financonte dezertorët?

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

1 PË. Ky do të ishte një veprim krejt ndryshe, do merrte një
2 drejtim tjetër. Këto janë burimet për qeverinë në ekzil,
3 shëndetësi, arsim dhe s'do t'i përdorim për këtë qëllim nuk e
4 transformojmë për dikë tjetër.

5 Të financosh në mënyrë aktive dezertorët do të ishte një
6 dimension tjetër, që për mua do të ishte krejt i pazakontë. Po
7 si ju thashë, unë kam qenë i shkëputur prej kësaj.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do të lexoj tre pyetjet e
9 tjera dhe pastaj do ju bëj disa pyetje. Pra, janë pyetjet dhe
10 përgjigjet. Vazhdohet më tej në tekst dhe gazetari bën këto
11 pyetje. Është një fjali në fakt, nuk e di nëse e ka thënë z.
12 Krasniqi apo gazetari, megjithatë këtu thuhet:

13 "Ai në këtë komunikatë kërkoi ndërprerjen e fondit
14 Vendlindja Thërret."

15 Më pas thuhet kjo fjali nga gazetari që:

16 "Ai ka kërkuar gjithashtu presion mbi 'qeverinë' për
17 mjetet, sidomos nga fondi Vendlindja Thërret. Cili është
18 komenti juaj lidhur me këtë?"

19 Në koment Jakup Krasniqi thotë:

20 "Ai në këtë komunikatë kërkoi ndërprerjen e fondit
21 Vendlindja Thërret, i cili është i vetmi fond që ka dhënë
22 kontribut të vërtetë që prej fillimi dhe deri në këtë ditë.
23 Kërkesa e tij është t'i ndërpritet financimi Ushtrisë
24 Çlirimtare të Kosovës dhe të pamundësojë vazhdimin e luftës
25 për liri dhe pavarësi."

1 Gazetari më pas bën pyetjen tjetër:

2 "Ai vazhdon edhe më t'i mbaj mjetet e bllokuara. Deri kur
3 do të vazhdojë ky avaz i tij dhe i 'qeverisë' së tij?"

4 Ndërkohë këtu thuhet që përgjigja e z. Krasniqi ka qenë
5 si më poshtë:

6 "Ai do të vazhdojë kështu derisa të kuptojnë
7 bashkatdhetarët se Bukoshi me bllokimin financiar që u ka bërë
8 UÇK-së i ka lënë hapësirë Serbisë fashiste të kryejë masakër
9 pas masakre derisa të kuptojnë edhe ata përgjegjësinë që kanë
10 për dhënien e djersës së tyre në adresë të gabuar.
11 Përgjegjësia e Bukoshit para popullit dhe historisë është
12 tepër e madhe."

13 Gazetari:

14 "Këto deklaratat të tij nuk janë të parat. Ai çdo herë pas
15 ndonjë ofensive ose masakra serbe ka deklaruar se 'qeveria' e
16 tij ka dhënë kaq e kaq mjete për luftën. A mos është edhe kjo
17 një përpjekje për të provokuar ndjenjat e mërgimtarëve pas
18 Masakrës së Reçakut dhe kështu të mbushë arkën e tij?"

19 Përgjigja që jep Jakup Krasniqi sipas këtij dokumenti
20 është:

21 "Bukoshi dhe 'qeveria' e tij masakrat e kryera në
22 Likoshan, Qirez e Prekaz e deri në këtë të Reçakut i ka
23 shfrytëzuar për grumbullimin e mjeteve financiare për luftën,
24 të cilat jo vetëm i ka bllokuar por në shumë raste i ka
25 shfrytëzuar kundër tij. Ai edhe tani vazhdon të luajë

1 paturpësisht me ndjenjat e liridashësve e bashkatdhetarëve në
2 botën e jashtme. Tani mendoj se është koha e fundit që Bukoshi
3 dhe njerëzit e tij ta pyesin veten se për ku janë nisur.”

4 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është që a jeni në
5 dijeni të ndonjë vërtetësie të këtyre deklaratave të bëra
6 këtu, në veçanti për faktin në qoftë se z. Bukoshi ka vepruar
7 në mënyrë të tillë që të cenonte ose të pengonte përpjekjet e
8 UÇK-së?

9 PË. Nuk jam në gjendje të komentoj lidhur me vërtetësinë e
10 informacionit që jepet këtu dhe të faktit në qoftë se Bukoshi
11 në mënyrë aktive mendohej që të pengonte përpjekjet e UÇK-së,
12 ajo çfarë mund të them unë është që thjesht të shtojë, nëse më
13 lejoni, që ai, domethënë, ishte disi i ngurruar, i tërhequr
14 për sa i takon përdorimit të fondeve të diasporës së LDK-së
15 për çështje shëndetësore, për pakicat dhe për gjëra të tjera
16 për t’i ndarë ato me UÇK-në.

17 Së dyti, pa komentuar në hollësi për deklaratën, kjo në
18 përgjithësi është në përputhje me narrativen që është
19 shpalosur me kalimin e kohës që qeveria në mërgatë ka burime
20 për shkak të diasporës që lëvizja e armatosur jo shtetërore ka
21 nevojë për këto burime dhe që të duhej që qeveria në mërgim të
22 ndante këto burime. Nuk e di në qoftë se isha i qartë
23 mjaftueshëm por kaq mund të them sa i takon këtyre aspekteve.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani do të kërkoj që të
25 paraqitet një tjetër dokument në ekran. Dokumenti ka numrin

1 ERN KSC-BC-2020-06-IT-05-87-1D00018. Domethënë, është një
2 libër që e keni parë edhe gjatë pyetjeve të palëve të tjera.
3 Është libri i Marc Weller. Ti kërkojmë Sekretares ta paraqesë
4 librin në ekran. Titulli i librit është, "Kriza në Kosovës".
5 Ju lutem kaloni në faqen 338 të librit, që përndryshe është
6 faqja 335 në versionin në PDF, numri ERN është 1D036.

7 Do kërkoja që ta zmadhonit, ky është dokumenti, ta
8 zmadhoni në mënyrë të tillë që ta shohin më qartë palët.

9 Është një fragment i marrë nga libri i marrë nga libri i
10 z. Weller. Do ju kërkoja që të lexonit pikën 32 në mënyrë të
11 tillë që të keni pak kontekst përpara sesa t'ju bëj pyetjen.
12 Është një letër nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të
13 Bashkuara që i drejtohet Presidentit të Këshillit të Sigurimit
14 dhe mban datën 23 mars 1999. Pra, në shtojcën e parë është
15 letra nga kryetari i OSBE-së në Sekretarinë e Përgjithshme. Do
16 fillojmë drejt fundit të faqes duke lexuar.

17 Do i kërkoja Sekretarisë që të zmadhonte pak më shumë
18 paragrafin e fundit në të djathtë të ekranit.

19 Do ju lutesha Sekretar, që të shikoni pikën "Situata
20 politike". Lexojeni pa zë dhe pastaj do ju bëj disa pyetje
21 lidhur me këtë paragraf.

22 PË. E lexova.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Aspekti i parë për të
24 cilin unë jam i interesuar është që këtu thuhet që:

25 "Adem Demaçi dha dorëheqjen si zëdhënës politik i UÇK-së

1 më 2 mars", besoj do ketë qenë 1999, "në atë çfarë duhej që
2 tregonte se kishte ndryshim brenda përbrenda UÇK-së lidhur me
3 pranimin e Marrëveshjes së Përkohshme për të cilën u bën
4 biseda në Rambuje."

5 Pyetja e parë që kam për juve është që në qoftë se jeni
6 në dijeni nëse Adem Demaçi ka dhënë dorëheqjen e vet si
7 zëdhënës politik më datë 2 mars?

8 PË. Më 2 mars 1999, unë nuk kam qenë në dijeni të dorëheqjes
9 së z. Demaçi. Por më pas, u informova lidhur me këtë.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nuk dua që t'ju vendos
11 fjalë në gojë, por ju përshkruat që qëndrimi politik dhe
12 diplomatik i UÇK-së ndryshoj me kalimin e kohës. Ndërkohë që
13 këtu thuhet që dorëheqja e z. Demaçi ishte "një tregues i
14 ndryshimit dhe të qëndrimit të UÇK-së brenda përbrenda saj sa
15 i takon pranimin të Marrëveshjes së Përkohshme ..."

16 A pajtoheni ju me këtë, Dëshmitar?

17 PË. Po. Mund të jap edhe kontekst shtesë sa i takon natyrës
18 së këtij ndryshimi, në qoftë se jeni i interesuar.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po. Vazhdoni, ju lutem.

20 PË. Atëherë Marrëveshja e Rambujesë kishte shumë shtresa,
21 shtresëzime, shumë dimensione. Atëherë së pari kishim të bënim
22 me tekstin e marrëveshjes, në të cilin kam qenë i përfshirë
23 vetë dhe ideja ishte rreth termit duhej përfshirë pavarësia
24 shprehimisht apo jo.

25 Ndërkohë që një tjetër element kishte të bënte me natyrën

1 e shtojcës së sigurimit dhe asaj çfarë do të bënte NATO në
2 qoftë se do nënshkruhej marrëveshja politike dhe në qoftë se
3 NATO do ndërhynte.

4 Dhe do kaloj te një tjetër pikë, pika e tretë më pas.
5 Megjithatë, më lejoni të them për momentin që dinamika këtu ka
6 qenë e ngjashme si me dinamikën në Dayton, ku unë kam
7 këshilluar për boshnjakët dhe kjo ishte që: Nuk ishte
8 ekzaktësisht e rëndësishme se çfarë thuhej në marrëveshje por
9 ju do merrni dhjetëra mijëra trupa të NATO-s në vendin tuaj
10 për të mbrojtur popullin tuaj. Pra, në Dayton, unë kam qenë në
11 një takim ku është thënë shprehimisht që "Thjesht nënshkruani
12 dokumentin. Dhe ju do të merrni 50.000 të NATO-s". Këtë nuk e
13 kam dëgjuar shprehimisht në fakt në Rambuje, por tema kryesore
14 ose ideja kryesore kjo ishte.

15 Ndërkohë dimensionin e tretë, ose aspekti i tretë, ishte
16 që aleatët amerikanë dhe evropianë nuk kishin vështirësi që të
17 bënin një ndryshim 180 gradë. Ne këtu jemi për të mbrojtur të
18 drejtat e njeriut të shqiptarëve të Kosovës dhe në fakt kjo e
19 bëri Ambasadorin Mitch McConnell që të vinte në Rambuje.
20 Domethënë, u shpreh qartë që jemi gati që të mbrojmë të
21 drejtat e njeriut të shqiptarëve të Kosovës, ndërhyjmë. Dhe në
22 qoftë se ju nuk e nënshkruani dokumentin ju jeni armiq të tanë,
23 do t'ju ndërpresim financimet, do ju braktisim. Edhe në fund
24 fare serbët mund të bëjnë ç'të duan me ju. Kjo do ketë çuar në
25 ndryshimin e qëndrimit brenda UÇK-së. Besoj do kenë qenë

1 amerikanët në kontakt me komandantët lokalë për t'jua
2 transmetuar këtë mesazh. Dhe ky është transmetuar si mesazh
3 dhe brenda kështjellës.

4 Dhe, domethënë, dikush mund të thoshte që ky ishte
5 ndryshim i shpejtë dhe ishte dhe nuk është se jua them në fakt
6 me krenari këtë gjë, por amerikanët ti për një moment i kishe
7 miq, po për një çast mund t'i bëje dhe armiq në qoftë se nuk
8 bëhej diçka siç mendohej.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në paragrafin tjetër,
10 domethënë, përsëri në këtë paragraf më pas shkruhet:

11 "Më 3 mars tetë shqiptarë të Kosovës, pra, tetë parti
12 politike të shqiptarëve të Kosovës përfshirë këtu dhe LDK-në e
13 Ibrahim Rugovës, përfaqësuan në hije 'Parlamentin e Republikës
14 së Kosovës' të thërritur për të mbështetur Marrëveshjen e
15 Rambujesë, Marrëveshjen në parim të Rambujesë."

16 PË. Po. Delegacioni shqiptar në Rambuje, ndërkohë që nuk ra
17 dakord ose nuk u pajtua që të nënshkruante marrëveshjen në
18 kështjellë në Rambuje, i dërguan një letër Madeleine Albright
19 ku thuhej që synojmë ose planifikojmë që të nënshkruajmë
20 Marrëveshja e Rambujesë pasi të bëjmë konsultime - nuk e di se
21 cili ka qenë termi ose fjala ekzakte që u përdor - megjithatë
22 ideja ishte kjo që na duhet që të konsultohemi me popullin
23 kosovar. Dhe gjithashtu konfirmuan që e kuptuan paragrafin e
24 parafundit që flitej për referendumin, domethënë, në këtë
25 paragraf të flitej për gatishmërinë për vullnetin e popullit

1 dhe që ata të pranonin transformimin e UÇK-së.

2 Pra, domethënë, ideja ishte që së pari kosovarët nuk e
3 kishin nënshkruar Rambujenë kjo ishte e vërteta, dhe e dyta
4 ishte që ekzistonte një narrativë që thoshte që duhej që
5 ekzistonte "premtimi" që do nënshkruhej marrëveshja pasi të
6 konsultohesh populli Kosovë dhe pasi të merresh mbështetje për
7 marrëveshjen në parim të Rambujesë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Kjo më çon mua
9 në dy grupe të tjera pyetjesh.

10 Së pari, e para pyetje është kjo që ju e kishit vizituar
11 kolegun, domethënë, është një pyetje që e bëri kolegu im
12 Gjykatësi Barthe pak më përpara dhe ka të bëjë me takimin e
13 planifikuar ndërmjet Hashim Thaçit dhe Adem Demaçit.

14 Pyetja ime e parë është shumë bazike, dua t'ju pyes në
15 qoftë se keni informacion nëse takimi realisht është realizuar
16 apo jo, e keni këtë informacion, apo jo, Dëshmitar?

17 PË. Unë gjithmonë e kam menduar që ka ndodhur ai takim. Këtë
18 përgjigje kam. Ose mbase për ta thënë ndryshe më mirë, nuk kam
19 informacion faktik për të mbështetur faktin nëse ka ndodhur
20 apo jo. Por unë gjithmonë kam thënë që ai fluturoi drejt
21 Sllovenisë për t'u takuar me Adem Demaçin e kam menduar që ai
22 takim ka ndodhur. Megjithatë fakte për ta mbështetur këtë
23 supozim nuk kam.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një pyetje tjetër
25 plotësuese. Ju nuk keni marrë asnjëherë asnjë raport ose, në

1 goftë se keni marrë më thoni, nuk kemi marrë asnjë raport
2 lidhur me natyrën ose me përmbajtjen e këtij takimi, a është e
3 drejtë të thuhet kjo?
4 PË. Po. Përgjigja ime për anëtarët -- atëherë ju thashë edhe
5 një herë që ju thashë anëtarëve të delegacionit kosovar "Ku
6 është Thaçi sot? Dhe ata më thanë që "Z. Thaçi ka fluturuar në
7 Slloveni për t'u takuar me z. Demaçi". Pra, dëgjohej,
8 dëgjoreshin fjalë në kështjellë sa i takon z. Demaçi, çfarë
9 ndikimi kishte z. Demaçi lidhur me bisedat me negociatat atje.
10 Nuk më kujtohen fjalët ekzaktësisht, megjithatë unë kërkoja që
11 të lexoja ose le të themi që të kuptoja situatë, megjithatë
12 duke mbajtur distancën nga delegacioni, domethënë, duke
13 mbajtur një lloj distance të caktuar me ta.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pse ishte e nevojshme që
15 të bëhej takimi midis z. Thaçi dhe komandantëve të zonës së
16 UÇK-së dhe juve i jeni përgjigjur kësaj në paragrafin 39 të
17 deklaratës, që e përsëritët dhe disa herë të tjera gjatë
18 pyetjeve të bëra. Pyetja që kam aktualisht tani është në qoftë
19 se jeni në dijeni apo jo që takime të tilla, pra, të kësaj
20 natyre kanë ndodhur apo jo në fakt në kohën e ndërmjetme pra,
21 në kohën përpara sesa të nënshkruhej marrëveshja?

22 PË. Kam më shumë informacion për t'ju përgjigjur pyetjes
23 tuaj. Domethënë, në qoftë se ju do më thoni që të bëj një
24 listë të takimeve dhe me kë është takuar z. Thaçi me kë
25 komandant zone, këtë nuk jua bëj dot, nuk e them dot. Por

1 pyetjes dhe në qoftë se ju më pyesni mua që a mund të provoj
2 ose a kam informacion faktik për të mbështetur ose për të
3 provuar që z. Thaçi është takuar me komandantët e zonës,
4 përgjigja është jo.

5 Arsyeja që pse e kam këtë mendim është që kur u ktheva në
6 Washington kam pasur biseda të gjëra dhe të gjata me diasporën
7 shqiptare të Amerikës dhe i kam pyetur të më thonë që "Çfarë
8 po ndodhte? Cilat ishin zhvillimet?". Dhe më kujtohet që ata
9 më kanë thënë se "Hashim Thaçi duhet që të kthehet të flasë me
10 komandantët lokalë". Edhe një herë janë thashetheme, janë
11 fjalë që më kanë thënë ata, domethënë, thjesht po ju përsëris
12 çfarë më kanë thënë ata mua, pra, "Ai po shkon nga njëra zonë
13 tek tjetra, domethënë, po merr nënshkrimet e tyre, ka një
14 letër me vete e tjera". Dhe një herë këtë më kanë thënë mua
15 shqiptarët e Amerikës, këtë po ua them unë juve, pra, thjesht
16 "Kishte shënime me vete që ua tregonte të tjerëve që dikush
17 tjetër kishte nënshkruar aty". Dhe kjo çoi në situatën e Bob
18 Dole, që në qoftë se doni mund t'ju shpjegoj apo jo.

19 Dhe për këtë arsye ua them me siguri që ai ka shkuar në
20 terren për të mbledhur nënshkrimet e komandantëve të zonës.

21 Mbase ju dhashë më shumë informacioni seç duhet, ju
22 kërkoj ndjesë për këtë. Megjithatë, paralelisht me këtë kishte
23 një kosto të caktuar, një koste domethënëse politike do të
24 thoja sa i takon marrëdhënies me Bob Dole sepse ai ishte në
25 terren. Pra, ai ishte "në terren" dhe nuk e kishte të mundur

1 që të takoheshe me Senatorin Bob Dole dhe kjo pati një kosto
2 domethënëse politike. Ndërkohë që unë u sigurova që ai, në
3 fakt, ishte në terren, ishte duke u takuar me komandantët e
4 zonave.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju lutem mos e merrni si
6 kritikë personale. Por pyetja që kam tani është: A keni qenë
7 ndonjëherë në gjendje që të konfirmoni informacionin që u
8 është dhënë në dorë të dytë ose në dorë të tretë, pra,
9 informacionin që keni marrë nga burime të tjera, a keni marrë
10 informacionin që provonte faktin që z. Thaçi është takuar me
11 këta komandantë zonash dhe a ju janë dhënë emra të personave
12 me të cilët ai supozohet që të jetë takuar?
13 PË. Jo. Nuk e marr si kritikë aspak, sepse marrëdhënia ime me
14 shqiptarët e Kosovës ishte që unë të kisha aq njohuri sa më
15 nevojiteshin, pra, kisha informacion për aq sa më nevojitej.
16 Kjo ishte jo e thënë shprehimisht, po kjo ishte e nënkuptuar.
17 Unë jam takuar me Dino Hasanin në një fshat dhe ai ka thënë
18 që, për shembull, jam takuar me disa veta të tjerë dhe ai më
19 ka thënë që "Këta janë shokët e mi". Por nuk është se kam
20 marrë ndonjë kartëvizitë të tyre për të ditur ekzaktësisht se
21 kush ishin këta persona.

22 Si ish-zyrat i Departamentit të Shtetit, si amerikan,
23 gjithkush mendon që un jam person i CIA-s përpara se unë të
24 demonstroj të kundërtën, kështu që unë jam shumë i kujdesshëm
25 përpara sesa të kërkoj hollësi të tjera, të kërkoj më shumë

1 informacion saç më nevojitet.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Thjesht po mundohem të di
3 se sa mund të thoni ju ose çfarë dini ju, po duke marrë
4 parasysh atë çfarë thatë më përpara, domethënë, duke marrë
5 parasysh natyrën e informacionit që keni marrë ju nga ku e ka
6 pas burimin ky informacion dhe aftësitë tuaja, pyetja që kam
7 për ju është kjo: A keni pasur informacion ose ndonjë tregues
8 nga informacioni që keni marrë ju që ndoshta komandantët e
9 tonave nuk pajtoheshin me nënshkrimin e Marrëveshjes së
10 Rambujesë, domethënë, nga informacioni që keni dëgjuar, nga
11 çfarë ju është thënë ju nga palë të treta, nga persona të
12 ndryshëm, a e keni marrë këtë informacion apo jo? Ose, ndoshta
13 në qoftë se kanë rezistuar kundër nënshkrimit, apo jo, në
14 qoftë se e keni këtë informacion, ju lutem na e shpjegoni.
15 PË. U bë një takim me Dino Hasanin në fshat dhe ishte e qartë
16 si drita e diellit dhe mua mu kërkua që të luaja një rol të
17 vogël lidhur me këtë. Domethënë, u bë e qartë, si drita e
18 diellit, siç e thashë, që komandantët e zonës duhej që të
19 bëheshin pjesë të procesit, po mundohem që të jem sa më i
20 qartë të jetë e mundur. "Brenda përbrenda kështjellës ishte e
21 pamundur që të përcaktohej statusi i ardhshëm i Kosovës.
22 Kështu që, çfarë unë thashë që Paul të besojmë. Ja tani merre
23 këtë copën e letrës. Shko jepe këtë mesazh. Shko dhe bëju
24 avokati ose këshilltari i UÇK-së. Dhe na informoni plotësisht
25 neve, na thoni me transparencë të plotë se çfarë po ndodhë aty

Dëshmitari: Paul Williams (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 59

1 brenda dhe ku, çfarë drejtimi ka procesi në mënyrë të tillë që
2 dhe komandantët të informohen", Domethënë, nuk është se më
3 është thënë shprehimisht kështu, nuk është se më janë thënë
4 këtu ekzaktësisht, po ideja ishte apo po flitet për
5 pavarësinë, a do kemi mbështetjen e NATO-s e të tjerë. Ata
6 ishin të gjithë harmonizuar, të linjzuar. Nuk e di tani në
7 qoftë se kanë qenë të linjzuar me Adem Demaçin apo jo, por të
8 gjithë në Rambuje ishin të përfshirë që të siguronin
9 përfshirjen konstruktive në procesin e negociatave.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam
11 pyetje tjera për ju.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
13 gjysëm ore pushim sipas planit, Dëshmitar.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
17 pushim deri në orën 11.30.

18 --- Pauza fillon në orën 10.58

19 --- Seanca rifillon në orën 11.30

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

21 Sekretare, mund të sillni Gjykatësin -- dëshmitarin në sallë,
22 më falni.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

25 Doktor, tani Gjykatësi Gaynor në anën e djathtë timen do t'ju

1 bëjë disa pyetje.

2 DËSHMITARI: Në rregull.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dr. Williams, sipas dëshmisë
4 suaj, Shtojca 8 [Sipas përkthimit] e jetëshkrimit tuaj, është
5 e qartë që ju keni përfaqësuar disa qeveri dhe aktorë
6 joshetërorë në Evropë, Afrikë, Azi, në negociata komplekse.
7 PË. Po.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pyetja është: A kam të
9 drejtë të them që shumë prej këtyre negociatave ishin të
10 ndjeshme, negociata për marrëveshje të rëndësishme së madhe për
11 popullsitë e vendeve të përfshira?

12 PË. Po.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Thatë që:

14 "... rreth 30" --

15 Më herët sot thatë që:

16 "... në dy të tretat e rreth 30 bisedimeve, negociatave
17 me të cilat kam punuar, personat që kishin autoritet komande
18 dhe kontrolli nuk ishin në dhomë, pra në sallën e bisedimeve."

19 PË. E saktë.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani do të përqendrohem tek
21 një e treta e bisedimeve, negociatave për të cilat personi që
22 kishte autoritet komandues ishin aty, në fakt, në dhomë.

23 Tani, lidhur me këto bisedime, kur ju ishit në procesin
24 ku përpiqeshit të siguronit të merrnin pëlqimin për
25 marrëveshjen përfundimtare, personi që kishte kontroll dhe

1 komandë thjesht nënshkruante marrëveshjen pa konsultuar
2 askënd, apo ishte më shumë normale që ky person të konsultohet
3 me dikë tjetër qoftë përmes telefonit apo fizikisht me njerëz
4 të vendit të tij dhe të komunitetit të tij?

5 PË. Mund t'ju përgjigjem duke dhënë disa raste të ndryshme.
6 Në rastet kur -- që më kujtohen menjëherë, ku ata kanë
7 nënshkruar në sallë, mund t'ju jap dy shembuj që mund të
8 ndihmojnë.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Vazhdoni.

10 PË. Kur kam përfaqësuar armenianët gjatë negociatave në Key
11 West ka qenë Presidenti Kocharyan dhe Ministri i Punëve të
12 jashtme Oskanian me Colin Powell në Shtëpinë e Bardhë, pranuan
13 që të nënshkruanin. Këto ishin fusha të cilat nuk u pajtuan që
14 të nënshkruanin. Pra, nuk funksionoi.

15 Në marrëveshjen, në bisedimet e Dayton tre udhëheqësit
16 politikë u pajtuan, ranë dakord që të nënshkruanin bisedimet e
17 Dayton.

18 Në marrëveshjen e Dohës El-Tijani Sissi, i cili
19 përfaqësonte El JEM, pranoi që të nënshkruante. Këto ishin
20 negociata që kanë zgjatur dy vjet, pra, me një ecuri të
21 ndryshme. Dhe në këtë rast, disa prej pjesëtarëve të
22 delegacionit të Darfurit, siç ishte, për shembull, konkretisht
23 JEM, ishte Gibrial dhe vëllai i tij që ishte Ibrahim, pra,
24 komandant, dhe ata nuk nënshkruan dhe nuk nënshkruan pa u
25 konsultuar ai. Pra, shpresoj që kjo të japë një kontekst.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe ju keni qenë në situata
2 gjatë këtyre -- gjatë procesit që ka çuar në ditët e fundit
3 përpara nënshkrimit, personi që kishte kontroll dhe komandë,
4 pra, merrte qëndrimin që ata duhej të konsultoheshin me të
5 tjerë që ishin pjesë e bashkësisë, komunitetit të tyre, të
6 merrnin pikëpamjet e tyre dhe në qoftë se ishte e nevojshme
7 t'i bindnin ata se ishte në interesin kombëtar të nënshkruanin
8 marrëveshjen?

9 PË. Po përpiqem të kujtohem. Një që do vinte, për shembull,
10 më kujtohet në disa shembull dhe më së fundi kemi negociatat
11 në Siri. Ata sollën segment përfaqësues të gjerë të shoqërisë
12 civile në Gjenevë. Pra, kishte bisedime, konsultime në vazhdim
13 gjatë negociatave, kishte dhe pushime gjatë bisedime për
14 raundeve 1, 2, 3, 4, 5, që janë mbajt në Gjenevë gjatë të
15 cilave vazhdonin konsultimet.

16 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A do ta konsideronit ju këtë
17 diçka që është e dobishme për të siguruar paqe të qëndrueshme
18 që secila palë përpara se të nënshkruante marrëveshjen të kenë
19 një pëlqim të vërtetë të komunitetit, të bashkësisë apo të
20 palës që ata përfaqësojnë?

21 PË. Po.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe a do të konsideronit
23 rrjedhimisht që konsultimi gjatë negociatave, qoftë përmes
24 telefonit apo fizikisht, përpara nënshkrimit të marrëveshjes
25 është diçka pozitive dhe në shumë forma, pra, është një

1 element i domosdoshëm për të siguruar një paqe të qëndrueshme?
2 PË. Po. Në terma të përgjithshëm, po. Duhet të gjendet një
3 ekuilibër mes një -- ekuilibër, pra, mes lëshimeve që duhet të
4 bëhen dhe negociatave në një farë niveli, shkalle
5 konfidencialiteti. Por nga pikëpamja ime personale përfshirja
6 është diçka e dobishme që duhet. Pra, komunikimi për një paqe
7 të qëndrueshme është i nevojshëm.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani i kthehemi kontekstit
9 të Rambujesë, nëse Hashim Thaçi është konsultuar përmes
10 telefonit satelitor me pjesëtarë të tjerë të UÇK-së, qoftë në
11 Kosovë apo në shtetet tjera, apo nëse ka shkuar atje fizikisht
12 për të biseduar me komandantët e zonave për të shpjeguar
13 marrëveshjen, siç e shpjeguat gjatë pushimit -- përpara
14 pushimit, a ka kishte ndonjë gjë gabim me këtë që s'shkonte, a
15 ishte -- a nuk dëshirohej kjo? Apo ishte, në fakt, një mënyrë
16 pozitive për të vepruar për të punuar?

17 PË. Nuk do ta karakterizoj si të padëshirueshme dhe mënyra
18 si ju e përshkruani që do të ishte pozitive, konsultimi pra,
19 bashkëndarja e informacionit. Jam hezitues, i pasigurt sepse
20 po përpiqem të jem relativisht i kujdesshëm që të mos analizoj
21 këtë duke u nisur nga parametrat e mi kulturorë, të hapjes,
22 transparencës, qarkullimit dhe ndarjes së lirë të
23 informacionit që -- pra, duhet të jem i kujdesshëm lidhur me
24 këtë, por, po, pajtohem me temën e argumentit të deklaratës
25 tuaj lidhur me këto pika.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe për sa i takon aspekteve
2 të rëndësishme, që janë të rëndësishme për të gjitha palët,
3 siç është pavarësia, nëse pavarësia duhet të jetë pjesë e
4 marrëveshjes, kjo ishte pikë kyçe. A kishte ndonjë gjë gabim
5 me faktin që Hashim Thaçi të shkonte te komandantët të cilët
6 ishin, në fakt, në të vërtetë duke komanduar trupat në terren
7 dhe të verifikonte nëse ata ishin në rregull element apo
8 pajtoheshin me këtë element?

9 PË. Kjo ishte gjë e duhur për t'u bërë.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

11 PË. Në rregull.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
14 pyetje tjetër, z. Misetic?

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, z. Kryetar, na duhet një
16 minutë që të nxjerrim dokumentet të cilat do t'i përdorim për
17 të bërë pyetjet në qoftë se na lejoni.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] S'ka problem.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni. A
21 duhet që të largohemi ne, apo -- se duhet të jetë
22 shkurtimisht...

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Na duhen pesë minuta, në qoftë se
24 kjo na lejohet.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do të

Dëshmitari: Paul Williams (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic

Faqe 65

1 bëjmë një ndërprerje të shkurtër pesë minuta.

2 Dëshmitar, mund të ktheheni në dhomën e pritjes edhe të
3 hani edhe diçka ndoshta gjatë këtyre pesë minutave.

4 DËSHMITARI: Mendoj që i kam hëngër ato biskotat që ishin.

5 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
7 ndërpresim seancën për pesë minuta.

8 --- Seanca ndërpritet në orën 11.40

9 --- Seanca rifillon në orën 11.48

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
11 dëshmitarin në sallë, ju lutem.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 Pas pyetjeve të Gjykatësve iu jepet mundësia palëve dhe
14 për një mundësi tjetër për të bërë pyetje. Do të fillojë z.
15 Misetic.

16 DËSHMITARI: Në rregull.

17 Pyetje vijuese nga z. Misetic:

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Faleminderit, Dr. Williams, për praninë tuaj. Kam thjesht
20 edhe disa pyetje. Pyetjet e para lidhen me pyetjet e para që
21 iu bënë ju nga Gjykatësi Mettraux në lidhje me njohuritë dhe
22 lidhjet që kishit me Bujar Bukoshin dhe UÇK-në. Pra, njohuritë
23 që kishit ju për marrëdhëniet midis Bujar Bukoshit dhe UÇK-së.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do të kërkoj të shfaqim në
25 ekran dokumentin DHT03648.

1 PY. Shikoni që këtu është artikulli 9 tetor 1998. Besoj që
2 keni dëshmuar që në këtë kohë ju ishit këshilltar i z. Bukoshi
3 në periudhën e negociatave të versë thd të tetorit.

4 PË. E saktë.

5 PY. Besoj që thatë gjithashtu që e njihni Tim Judah?

6 PË. Po.

7 PY. Tim Judah ka shkruar këtë artikull dhe do e filloj me
8 paragrafin e parë dhe t'ju pyes se çfarë dini për këtë.

9 "Lufta në Kosovë është përkeqësuar dhe është bërë
10 vdekjeprurëse, pikërisht në momentin kur duhej një front i
11 [unifikuar] i bashkuar përballë katastrofës humanitare,
12 politikanët shqiptarë janë në grindje me njëri-tjetrin si
13 kurrë më përpara."

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Pastaj më poshtë paragrafi i
15 tretë.

16 PË. "Në qershor në momentin më të mirë të tyre Ushtria
17 Çlirimtare e Kosovës jo vetëm që kontrollonte pjesë të tëra të
18 mëdha të territorit po dukej që i kishte hedhur koshin e
19 historisë Ibrahim Rugovën, udhëheqësin pacifist të Kosovës.
20 Kjo nuk ishte, në fakt, kështu, Rugova kishte rënë poshtë, por
21 ai dhe kolegët e tij në Qeverinë në Ekzil filluan të
22 kundërpërgjigjeshin.

23 "Koka dhe truri pas përpjekjeve të qeverisë për të marrë
24 kontrollin e UÇK-së ishte Xhaferr Shatri, ministri i
25 informacionit të Rugovës i bazuar në Gjenevë, duke punuar me

1 Bujar Bukoshin, kreun e qeverisë, i cili jeton në Bon, ai ka
2 dërguar 14 oficerë ushtarakë në Shqipëri dhe Kosovë. Dy
3 pjesëtarë të kabinetit aktivizuan gjithashtu ministrinë në
4 fjetje të mbrojtjes duke emëruar Ahmet Krasniqin si ministër.

5 "14 oficerët edhe pse në mënyrë formale vepronin në
6 autoritetin e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovë së
7 tyre, (FARK), të FARK-ut, kishin qëllimin e tyre për të marrë
8 kontrollin e UÇK-së. Ide që të -- të marrin -- të ishin në
9 tavolinën e bisedimeve në pozicion force me qeverinë,
10 parlamentin dhe ushtrinë."

11 Tani, a keni patur ndonjë njohuri se z. Bukoshi kishte
12 apo ishte duke zhvilluar ushtirë e vet dhe verë dhe vjeshtë
13 1999:

14 PË. Po.

15 PY. Cila ishte kjo njohuri që dinit?

16 PË. Unë dija se kryeministri Bukoshi përpiqej të krijonte një
17 FARK bazuar fillimisht në Shqipëri dhe që përbëhej nga oficerë
18 shqiptarë apo oficerë që më parë kishin shërbyer në forcat
19 ushtarake të Jugosllavisë.

20 PY. A keni patur ndonjë diskutim me z. Bukoshi apo dikë
21 tjetër që vepronte në emër të Qeverisë në Mërgim lidhur me
22 këtë FARK?

23 PË. Bujar Bukoshi nuk më ka kërkuar kurrë konkretisht
24 këshillë lidhur me FARK-n, por në bisedat tona, bisedat e mia
25 me Bukoshin dhe bisedat e mia me diasporën shqiptaro-

1 amerikane, kjo ishte temë që ishte pjesë e bisedave që
2 ekzistonte, që kontribuonte dhe kjo ishte pjesë e tensionit të
3 thellë dhe ishte ndërmarrje e re e LDK-së për të krijuar një
4 krah të armatosur.

5 PY. A është bërë ndonjë bisedë në atë kohë që cilat ju
6 kujtohen në lidhje me përdorimin nga Qeveria e Bukoshit në
7 Mërgim e FARK-ut, pra, përdorimi i FARK-ut nga kjo Qeveri në
8 Ekzil si mjet për të marrë kontrollin e UÇK-së?

9 PË. Mesa më kujtohet, ajo që më kujtohet pra, është që FARK-u
10 do të ishte aktor tjerët shtesë i armatosur joshtetëror i cili
11 do të luftonte në emër të popullit të Kosovës dhe duke qenë që
12 do të ishte profesionist, pasi do përbëhej nga ish-oficerët e
13 ushtrisë jugosllave dhe kishte gjasa që të bëhej aktor më, në
14 mos më efikas dhe efektiv i armatosur joshtetëror dhe për
15 rrjedhore mënjanonte UÇK-në.

16 PY. Gjykatësi Mettraux përmendi, mendoj që ju thatë që 70 për
17 qind kështu e keni kuptuar këtë dinamikë dhe dinamikën që
18 ishte, pra, a arritën ata që ta mënjanonin UÇK-në?

19 PË. Mund të jeni pak më i saktë sa i takon dinamikës në
20 raport me marrëdhënien midis dy --

21 PË. Po.

22 PY. -- midis dy pra, z. Bukoshi dhe qeveria e tij dhe në anën
23 tjetër UÇK-ja, pra kjo dinamikë?

24 PË. Jashtëzakonisht e pakëndshme si dinamikë.

25 PY. Juve iu bënë disa pyetje lidhur me kontrollin nga z.

1 Bukoshi të parave, pra, që kontrollonte paratë dhe po ju bëj
2 një pyetje tjetër, më duhet pyetja paraprake që më lejon të
3 bëj këtë pyetje: A keni ndonjë njohuri për kush ishte Adem
4 Jashari?

5 PË. Jo tani që ju po më thoni, që po më pyesni këtë çast.

6 PY. Atëherë ta kaloj këtë pyetje.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të kalojmë më poshtë te
8 dokumenti. Në fakt, e heqim dokumentin dhe do të kalojmë pak
9 më poshtë, ju lutem.

10 PY. Ky personi, Xhafer Shatri, a keni patur ndonjë kontakt me
11 të?

12 PË. Nuk e njoh këtë emër.

13 PY. Faleminderit.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

15 PY. Tani Gjykatësi Mettraux ju pyeti lidhur me Adem Demaçin
16 dhe nëse ju njihni nëse është mbajtur një mbledhje, takim mes
17 të dy -- mes të atyre, pra në qoftë se është mbajtur një takim
18 dhe ju iu përgjigjët. Ju kujtohet kjo pyetje?

19 PË. Po, më kujtohet pyetja.

20 PY. Pra, për Adem Demaçin.

21 PË. Më kujtohet pyetja.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të doja që të nxjerrim
23 artikullin e *Washington Post* dhe në qoftë se mund të kalojmë
24 në DHT12053 deri në 2056. Dhe do të shohim, pra, që nga
25 arkivat e Monitorimit të Drejtësisë Ndërkombëtare. Kalojmë në

1 fund të faqes, pra, artikulli i datës 24 shkurt 1999, kalojmë
2 në faqen tjetër. Me 24 shkurt.

3 "Pra, Thaçi e Hill thanë përpara që të largoheshin nga
4 negociatat se 'vazhdonin të merrnin thirrje nga terreni duke
5 thënë që kjo ishte marrëveshje e keqe dhe duke mos pranuar
6 ata, ata do të vazhdonin luftën dhe në fund NATO-ja do të
7 ishte e detyruar që të ndërhynte gjithëses. Por unë ju thashë
8 atyre që ju nuk mund të keni NATO-n pa patur një marrëveshje
9 politike.'"

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër në
11 paragrafin në krye në mes. Paragrafi i parë në krye ku thotë
12 "Zyrtarët amerikanë sot ...". E shikoni këtë?

13 PË. Po.

14 PY. "Zyrtarët amerikanë sot fajësuan pjesërisht për dëshmimin
15 e arritjes së marrëveshjes përfundimtare Adem Demaçin, që
16 është përfaqësues politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i
17 cili refuzoi, nuk pranoi të merrte pjesë në bisedime. Pasi
18 fillimisht këshilluan dhe udhëzuan kolegët e tij në ushtrinë
19 rebele që -- pasi i udhëzoi kolegët e tij në ushtrinë rebele
20 që të mos merrnin pjesë në bisedime, Demaçi të premten u takua
21 në Slloveni me Thaçin dhe e inkurajoi atë që të kishte qëndrim
22 të ashpër", thanë zyrtarët amerikanë.

23 "'Ishte personi që nuk ishte aty në Francë, i cili i
24 prishi gjithçka', në minutë të fundit tha zyrtari.

25 "Por, persona të tjerë që ishin afër -- të afërt me

1 bisedimet thanë se problemi ishte më i madh. Ushtria
2 Çlirimtare e Kosovës 'kishte frikë për të ardhmen e saj', tha
3 një diplomat evropian. Psikologjikisht ata kishin probleme për
4 t'u zhbërë si organizatë. Kjo ishte pengesa kryesore që ata të
5 nënshkruanin. Ata nuk morën siguri, garanci të mjaftueshme se
6 NATO-ja do të -- nuk do të vepronte kundër tyre si dhe trupat
7 dhe trupave qeveritare të cilat janë fajësuar për pjesën më të
8 madhe të dhunës. Paul Willians, profesor i universitetit
9 amerikan i së drejtës kushtetuese i cili ishte këshilltar i
10 ekipit shqiptar negociator u shpreh se problemi -- e shprehu
11 problemin më -- në mënyrë më të butë 'Disa prej delegatëve
12 kanë elektorat që është veçanërisht i ndjeshëm dhe duan të
13 jenë të sigurt kur të marrin një hap përpara apo prapa'..."

14 Tani, pyetja ime e parë, zoti -- doktor, është Dr.
15 Williams, "Paul Williams profesor universiteti amerikan i së
16 drejtës kushtetuese", jeni ju?

17 PË. Po.

18 PY. A e keni parë këtë artikull kur është botuar apo rreth
19 asaj kohe?

20 PË. Po. Jam intervistuar shpesh nga Jeffrey Smith dhe besoj
21 që e kam lexuar këtë artikull.

22 PY. Në artikull thuhet që "Adem Demaçi u takua të premtën në
23 mëngjes në Slloveni me Thaçin". E keni parë këtë në atë kohë?

24 PË. Me shumë gjasë duhet ta kem parë dhe lexuar këtë artikull
25 në atë kohë.

1 PY. E premtja në mëngjes i bie të ketë qenë 19 shkurt.

2 PË. Në rregull.

3 PY. Më herët ju lexova një paragraf ku artikull thuhet që

4 "Thaçi merrte thirrje telefoni nga terreni". Përputhet kjo me

5 atë që ju po na thoni këtu?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe këtu ju citoheni të keni thënë që "disa prej

8 delegatët kishin elektorate, pra, votuesish jashtëzakonisht të

9 ndjeshëm ..."

10 Për kë e keni fjalën?

11 PË. Thaçi dhe UÇK-ja.

12 PY. Faleminderit.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar paraqes këtë dokumentin

14 DHT12053 deri në DHT12056 për t'u pranuar si provë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë

16 kundërshtim?

17 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT12053-

19 DHT12056 pranohet. Në qoftë se nuk është publik duhet të bëhet

20 publik.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo merr numrin e

22 provës materiale 1D379 dhe është publik.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare mund të shfaqim në

24 ekran dokumentin DHT12058.

25 PY. Dr. William, kjo është një deklaratë për shtyp e lëshuar

Dëshmitari: Paul Williams (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic

Faqe 73

1 nga Ministria e Punëve të Jashtme e Sllovenisë më 19 shkurt
2 1999, ku thonë se:

3 "... do të mbahej një seancë për shtypin me e kreun e
4 delegacionit shqiptar të Kosovës në Rambuje në konferencën e
5 pages, Hashim Thaçi, dhe përfaqësuesin të Ushtrisë Çlirimtare
6 të Kosovës, Adem Demaçi, dhe kjo konferencë është planifikuar
7 për orën 5.00 pasdite ditën e premte. Të gjithë -- të dy, më
8 falni, përfaqësuesit shqiptarë të Kosovë do të jenë të
9 disponueshëm të flasin me shtypin në aeroportin e Lubjanës".

10 Ju kujtohet pra që z. Thaçi ka shkuar në Lubjanë për të
11 takuar Adem Demaçin?

12 PË. Po.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj pranimin e deklaratës për
14 shtyp.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
16 kundërshtime z. Pace.

17 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 Materiali DHT12058 pranohet dhe është publik.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materiali do të marrë
21 numrin provës 1D380.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem tani vendosni në ekran
23 materialin DHT -- më lejoni, më fal, të bëj një verifikim. Po.
24 DHT12057 është materiali.

25 PY. Dr. Williams, njihni ndonjë prej personave në fotografi?

Dëshmitari: Paul Williams (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetiç

Faqe 74

1 PË. Njoh Hashim Thaçin, dhe zotninë në të djathtën e tij që
2 duket sikur është Adem Demaçi nga fotografitë që kam parë.

3 PY. Një nga mikrofonët e lexon TVSLO, a e keni idenë çfarë
4 mund të jetë kjo TVSLO? Na ndihmoni?

5 PË. Mbase televizioni i Sllovenisë.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj pranimin e kësaj fotografie
7 si provë gjyqësore.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
9 kundërshtime?

10 Z. PACE: [Përkthim] A kemi ndonjë informacion për
11 prejardhjen e kësaj fotografie? Çfarë po shohim këtu? Ka
12 ndonjë gjë te metadatat?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Te Google.com mund ta gjeni, tek
14 imazhet. Është një fotografi e të dyve në Slloveni.

15 Z. PACE: [Përkthim] Nuk e kam për detyrë unë të
16 kontrolloj fotografitë në Google. Po ju pyes ku e keni gjetur
17 këtë fotografi dhe cila është themelësia e fotografisë. Ju
18 lutem na informoni.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Është tek metadatat, mund ta gjeni
20 tek metadatat. Edhe dëshmitari ka dhënë kontekst lidhur me
21 fotografinë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
23 DHT12057 pranohet.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marri numrin e
25 provës P381.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

2 PY. Së fundi, Dr. Williams, ju janë bërë disa pyetje nga
3 Gjykatësi Gaynor lidhur me dinamikën e një udhëheqësi në
4 sallë, jashtë salle dhe ai ishte mirë që të ktheheshit që të
5 diskutoni me zgjedhësit. Ju kujtohen këto pyetje?

6 PË. Po.

7 PY. A keni ndodhur të jeni në ndonjë negociatë ku një
8 drejtues, e përgjithshme, një komandant i përgjithshëm është
9 në procesin e negociatave dhe ndodh një komplot në terren,
10 ndërkohë që personi është në një konferencë duke kryer
11 negociatat për paqen, e në terren ka një komplot, puç?

12 PË. Po përpiqem të mendoj skenarët e ndryshëm. Nuk më
13 kujtohet ndonjë gjë e tillë, jo.

14 PY. Bazuar në përvojën tuaj, a do të kishte kjo ndonjë ndikim
15 në ekipin negociues po të ndodhte ndonjë komplot në terren?

16 PË. Po.

17 PY. Çfarë?

18 Z. PACE: [Përkthim] Kjo është komplet hipotetike. Si
19 qenka kjo relevante dhe si lidhet kjo me pyetjet e Gjykatësve?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po në fakt si
21 lidhet kjo me pyetjet e Gjykatësve?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të shtjelloj pak më shumë
23 pyetjet e Gjykatësit Gaynor për dinamikën.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk u përmend
25 komploti në asnjë mënyrë.

1 Z. MİSETIC: [Përkthim] Por mbase kjo ishte ndonjë nga
2 gjërat që mund ta diskutojmë më tej.

3 DËSHMITARI: Nëse do të kishte ndonjë komplet, atëherë do
4 të ishte e domosdoshme të ktheheshin e të konsultoheshin dhe
5 të rikthenin legjitimitetin, pra, t'ju jepnin legjitimitetin
6 pjesëmarrësve në proces.

7 Z. MİSETIC: [Përkthim]

8 PY. Faleminderit. Kaq pyetje kisha unë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
10 z. Misetiç.

11 Nga Mbrojtja ka pyetje të tjera?

12 Z. DIXON: [Përkthim] Jo.

13 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

14 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkurtimisht kam disa pyetje.

15 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Ellis:

16 Z. ELLIS: [Përkthim]

17 PY. Dr. Williams, kam shumë pak pyetje që burojnë nga një
18 dokument që iu tregoi Gjykatësi Mettraux.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Do lutesha që të vendosej dhe një
20 herë në ekran materiali që përdori Gjykatësi Mettraux. Është
21 materiali P4166.

22 PY. Ndërkohë që presim dokumentin, Dr. Williams, dëshiroj
23 t'ju pyes, gjatë kohës që keni parë çfarë ndodhte në Kosovë,
24 ju besoj se e keni dëgjuar masakrën e Reçakut në mes të
25 janarit 1999, apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. A është e vërtetë që ka qenë një cenim shumë i rëndë i të
3 drejtës ndërkombëtare humane sepse u vranë shumë civilë?

4 PË. Po.

5 PY. Nëse ju ka dalë dokumenti në ekran desha t'ju pyes, a e
6 shihni datën në krye në të djathtë, e enjte 21 janar 1999?

7 PË. Po.

8 PY. Pra i takon brenda një jave pas masakrës së Reçakut, apo
9 jo?

10 PË. Po.

11 PY. Nga sa keni parë ju me delegacionin kosovar a është e
12 vërtetë që masakra si Reçaku kishin një ndikim të
13 jashtëzakonshëm emocional tek këta?

14 PË. Po.

15 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtojmë. Ndonëse mund ta ketë
16 përdorur Gjykatësi Mettraux këtë dokument, pyetjet e avokatit
17 nuk lidhen me pyetjet e Gjykatësit Mettraux. Nuk më kujtohet
18 të jetë bërë ndonjë pyetje e tillë.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Pace, mesa po kuptoj
20 unë ai po eksploron pse mund të jetë përgjigjur klienti në
21 këtë formë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
23 kundërshtimi.

24 Vijoni z. Ellis.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

1 PY. A është e vërtetë se UÇK-ja kishte nevojë para në janar
2 të '99-s të blinte armatime, pajisje të mbronte popullatën
3 civile?

4 PË. Po.

5 PY. Dihej nga të gjithë asokohe që Qeveria në Ekzil, pra
6 Bukoshi kishte grumbulluar një shumë të konsiderueshme parash,
7 apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. A e dini ju se në janar të '99-s a ka pasur ndonjë
10 pasqyrë financiare për të treguar si i shpenzonte këto para
11 Qeveria në Ekzil?

12 PË. Jo.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Kaq pyetje kisha. Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

17 Dr. Williams, përfunduat.

18 DËSHMITARI: Faleminderit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
20 që erdhët, që ndatë informacionin. Ju urojmë gjithë të mirat.
21 Mund të largoheni nga salla e gjyqit.

22 DËSHMITARI: Ju faleminderit ju.

23 [Dëshmitari largohet]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë gjë
25 për të shtuar?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Dua t'ju informoj që do bëjmë
2 njoftimet përkatëse për dëshmitarin e javës tjetër. Ndryshime
3 nuk kemi të parashikuara, por mesa kemi parashikuar është --
4 mesa kemi parashikuar dëshmitari do të zgjasë deri të mërkurën
5 paradite. Nuk kemi dëshmitar tjetër për javën tjetër, kështu
6 që vetëm një dëshmitar po sjellin.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj unë
8 ndjesë për këtë. Nuk mund të vazhdonim pas të mërkurës javën e
9 kaluar.

10 Mirë. Shihemi javën tjetër, të hënë, të martë, e të
11 mërkurën - dhe shpresojmë që dëshmitarin pa përfundojmë këto
12 tre ditë të parashikuara.

13 Ju faleminderit të gjithëve dhe shihemi të hënë në orën
14 9.00.

15 Seanca ndërpritet këtu.

16 --- Seanca mbyllet në orën 12.11

17

18

19

20

21

22

23

24

25